



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i studimit të ciklit të tretë Doktoratë në:**

**“Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë**

**Universiteti “Metropolitan Tirana”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**1. Prof. Dr. Olimpjon Shurdi**

**2. Prof. Dr. Elson Agastra**

**Nëntor 2025**

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Doktoratë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sisteme Inteligjente”  
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Metropolitan Tirana
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Doktoraturë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	MAS Urdhër Nr. 105, datë 01.03.2022, i ndryshuar me Urdhër në 173, datë 03.04.2023 për “një ndryshim në urdhërin nr. 105, datë 01.03.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”, ku ndryshohet emërtimi në “ <i>Doktoratë në Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente</i> ”, Si dhe urdhërin nr. 522, datë 09.10.2024 ku ndryshon gjuha e programit të studimit nga shqip, në anglisht.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	I tretë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 deri në 5 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	-
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 8
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024, 2 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., PAE 2024-2025, 2 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., PAE
18	Numri i studentëve:	2022-2023, 3 student 2023-2024, 5 student
19	Komente / të tjera:	-

# PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me vendim Nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana". Në zbatim të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë, UMT me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018 të Ministrit përgjegjës për arsimin ka miratuar statutin e tij, tashmë me statusin si Universiteti "Metropolitan Tirana". Universiteti "Metropolitan Tirana", me njësitë kryesore të tij është akredituar institucionalisht me vendim të Bordit të Akreditimit nga ASCAL, Nr.05, datë 27.01.2023 me kohëzgjatje prej 5 vite, deri më 26.01.2028.

Aktualisht, Universiteti "Metropolitan Tirana" përbëhet nga 3 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje tre njësi bazë, të organizuara si më poshtë:

**Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT**, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

**Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës**, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

**Fakulteti i Ekonomisë**, që përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Programi i ciklit të tretë të studimit Doktoratë në "Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2022-2023 në zbatim të urdhërit të ministrisë përgjegjëse për arsimin nr. 105, datë 01.03.2022, i ndryshuar me Urdhër në 173, datë 03.04.2023, ku ndryshohet emërtimi në "Doktoratë në Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente", si dhe urdhërin nr. 522, datë 09.10.2024 ku ndryshon gjuha e programit të studimit nga shqip, në anglisht.

**Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT (FSHKIT)** është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit Doktoratë në "Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente". Njësi bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike** në bashkëpunim me njësitë të tjera akademike si dhe strukturave ndihmës akademike, administrative, të cilat japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit.

Programi në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL" dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente”.

Bazuar në Urdhërin nr. 92, datë 03.07.2025, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, për procesin e akreditimit e programeve, Universiteti “Metropolitan Tirana”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

1. Prof. Dr. Olimpjon Shurdi
2. Prof. Dr. Elson Agastra

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Janar 2025 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti Metropolitan, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM, nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 për “miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”; VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar; Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në UMT, në datat 26-27 Shkurt 2025, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Metropolitan Tirana. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 08.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 58/13 Prot., datë 08.10.2025, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 15.10.2025, dhe me shkresë zyrtare Nr. 148/1 Prot., datë 13.10.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

#### 1. IAL-UMT – koment:

Lidhur me komentin e institucionit për standardin III.4:

*Me sa jemi në dijeni, në vendin tonë nuk ka një ent që certifikon laboratorë në fushën e Inteligjencës Artificiale. Megjithatë, një laborator i tillë i shërben këtij programi.*

#### GVJ – përgjigje:

Jemi dakord se aktualisht në nivel kombëtar nuk ekziston një ent që certifikon laboratorë kërkimorë në fushën e Inteligjencës Artificiale, por në nivelin ndërkombëtar po. Megjithatë, vërejtja e bërë në raportin tonë nuk kishte për qëllim të nënkuptonte detyrimisht mungesën e një certifikimi formal, por të theksonte rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës kërkimore që mbështet programin e doktoratës. Prania e një laboratorit të dedikuar për kërkime në Inteligjencën Artificiale – të pajisur me burime teknologjike bashkëkohore dhe të ndërtuar sipas praktikave të mira ndërkombëtare – do të kontribuonte ndjeshëm në forcimin e komponentit praktik dhe shkencor të programit.

Një laborator i tillë, edhe pse jo i "certifikuar" në kuptimin ligjor, do të siguronte një mjedis kërkimor më të strukturuar për eksperimentime, testime dhe zhvillim projektesh shkencore, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e punës së doktorantëve dhe të udhëheqësve shkencorë. Në këtë mënyrë, rekomandimi ynë synon nxitjen e institucionit për të vijuar investimet në infrastrukturë kërkimore dhe për të ndërtuar një laborator të profilizuar në fushën e Inteligjencës Artificiale, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

#### Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

#### 2. IAL-UMT – koment:

Lidhur me komentin e institucionit për standardin IV.5, kriteri 1, 3 dhe 4:

*Kriteri 1: Në Rregulloren e programit të Doktoratës, neni 10, pika 2 (10.2), thuhet: "Anëtarët e jurisë propozohen nga njësisia bazë dhe miratohen nga njësisia kryesore. Numri i tyre është jo më pak se 8, nga të cilët Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore 'Doktor' zgjedh 5 anëtarë."*

*Ndërkohë, në Rregulloren e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", neni II/2, pika 6, përcaktohet se: "Ky komision është përgjegjës për miratimin e përbërjes së jurisë për mbrojtjen e doktoratës, mbi propozimin e njësisë bazë."*

*Kriteri 3: Procedura që ndjek kandidati për mbrojtjen e disertacionit përcaktohet qartë si në RVB, ashtu edhe në Rregulloren e Programit të Doktoratës, neni 10, pikat 10.3, 10.4, 10.5 dhe 10.6. Pika 10.6 paraqitet gjithashtu edhe në Rregulloren e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", Kreu II, pikat 3 dhe 4.*

*Kriteri 4: Sa i përket këtij kriteri, ... objektivat e përcaktuara nga kandidati dhe detyrimet akademike ligjore për marrjen e gradës "Doktor" janë të qarta dhe të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", Kreu II/2 dhe II/3. Ne mendojmë që nga analiza e ridërguar rezultojnë se nuk ka ndonjë mospërputhje midis përmbajtjes së RVB-së dhe rregulloreve të cituara me sipër. Megjithatë, e mirëpresim gjithmonë hapësirën për përmirësim.*

#### GVJ – përgjigje:

Kriteri 1: komenti i institucionit pranohet dhe RVJ ndryshon për këtë kriter.

Kriteri 3: Institucioni ka parashikuar në disa nene të rregullores procedurat që lidhen me mbrojtjen e disertacionit. Megjithatë, vërechet se emërtimet e neneve nuk përputhen gjithmonë me përmbajtjen e tyre. Si shembull, në rregulloren e programit të studimit, Neni 10 "Organizimi i Jurisë", përmban të detajuar

përshkrimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës nga kandidati, i cili e dërgon atë fillimisht tek drejtuesi i njësisë kryesore; më pas kërkesa përcillet tek njësia bazë, drejtori i shkollës dhe në fund në komisionin e përhershëm. Gjithashtu këtu përshkruhen afatet kohore të koordinatorit të programit të doktyoratës apo edhe afatet e vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm të gradës shkencore “Doktor”. Ku duksëm këto proceura janë të duhura, por jo të paraqitura nën emërtimin dhe nenin e duhur, pasi procedurat e paraqitura, nuk janë pjesë e organizimit të jurisë për mbrojtjen e disertacionit. RVJ ndryshon në këtë kriter duke pasqyruar më qartë rekomandimin e GVJ si më sipër.

Kriteri 4: komenti i institucionit pranohet dhe RVJ ndryshon për këtë kriter.

## Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente”

### I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT DOKTORAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Programi i studimit i ciklit të tretë doktoratë ofrohet nga institucione të arsimit të lartë që përmbushin kriteret ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i doktoratës ofrohet nga institucionet e llojit universitet ose akademi i akredituar në Republikën e Shqipërisë.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit (DVV), rezulton se programi i studimit Doktoratë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente”(IASI) ofrohet nga Universiteti “Metropolitan Tirana”(UMT) i cili është i licencuar në bazë të VKM Nr.357 datë 12.05.2010. Universiteti ka kryer riorganizimin në bazë të urdhërit të MAS, Nr.195 date 1.04.2019 duke plotësuar detyrimet ligjore konform ligjit të arsimit të lartë 80/2015. UMT ka kryer disa akreditime ndërvite, aktualisht UMT është i akredituar në bazë të vendimit të BA Nr.5 datë 27.01.2023 për një periudhë 5 vjecare, deri me 26.01.2028. Programi i studimit mbulohet nga njësia kryesore Fakulteti i Shkenceve Kompjuterike dhe IT(FSHKIT). Aneksi Nr. 1 - Statuti UMT Aneksi Nr. 4 - Urdhër i riorganizimit të UMT
<b>Kriteri 2.</b> Programi i doktoratës që ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit të jenë të akredituara në vendin e originës.	Programi i studimit IASI mbulohet vetëm nga UMT, kjo është e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe në dokumentat e tjerë të hapjes se këtij program studimi. Nga diskutimet me profesorët udhëheqës të studentëve u konstatua se, për disa tema, është konsideruar bashkëpunimi individual me profesorë të shquar të fushës, me qëllim sigurimin e një cilësie të lartë akademike dhe një përvojë studimore të pasur. Aneksi Nr. 10 – Rregullore e programit të studimit
<b>Kriteri 3.</b> Programi i doktoratës licencohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.	Nga shqyrtimi i dosjes së programit të studimit rezulton se ky program studimi është hapur bazuar në urdhërin e ministrit të MAS, urdhëri Nr.105 date 01.03.2022. Programi i doktoratës është licencuar në përputhje të plotë me Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Rezulton se ky program është hartuar dhe zhvilluar duke ndjekur procedura transparente në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në hartimin e programit janë ndjekur praktikat më të mira akademike dhe janë respektuar të gjitha aktet rregullatore të brendshme të UMT-së, duke përfshirë statutin, rregulloret dhe strategjinë e zhvillimit. Aneksi Nr. 8 – Licencimi i programit të studimit
<b>Kriteri 4.</b> Programi i doktoratës hartohet nga ana e institucionit	Programi i doktoratës IASI është hartuar nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në bashkëpunim edhe me njësi të tjera bazë

nëpërmjet procedurave të brendshme transparente dhe miratohet në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative të institucionit.	të njësisë kryesore FSHKIT, duke ndjekur procedura të brendshme transparente, të cilat janë bazuar në standardet akademike me të mira dhe rregulloret institucionale të vete universitetit. Procesi i hartimit dhe miratimit është zhvilluar në përputhje të plotë me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative, duke siguruar një strukturë të qëndrueshme dhe cilësi të lartë akademike. Pas hartimit dhe shqyrtimit në nivel fakulteti, rregullorja është miratuar përfundimisht nga Senati Akademik i universitetit UMT, duke siguruar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe akademike në fuqi. Aneksi Nr. 10 – Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 11 - Vendimi i Senatit për rregulloren e Doktoratës			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i doktoratës "Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente" i ofruar nga UMT plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe procedurale për ofrimin e një programi të ciklit të tretë. Ai është licencuar në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar dhe është hartuar përmes procedurave transparente, duke respektuar të gjitha aktet organizative të brendshme të institucionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit i ciklit të tretë doktoratë ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe të kërkimit shkencor të institucionit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i doktoratës hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të vetë institucionit.	Ky program studimi i ofruar nga Universiteti Metropolitan Tiranë, është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit akademik dhe kërkimor të institucionit. Ky program reflekton qartësisht prioritetet e institucionit për të ndërtuar kapacitete të avancuara kërkimore në fushat me ndikim të lartë si inteligjenca artificiale, automatizimi dhe teknologjitë digjitale, duke ndjekur trendet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut shqiptar dhe më gjerë. Hartimi i programit është bazuar në analizën e objektivave strategjike të universitetit, që përfshijnë promovimin e inovacionit, ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor, si dhe fuqizimin e lidhjes midis akademisë dhe industrisë. Në këtë kuadër, programi kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e misionit të institucionit për të përgatitur kërkues shkencorë të cilët do të jenë kontribues aktivë në zhvillimin e ekonomisë së dijes në Shqipëri dhe në rajon. Aneksi Nr. 5-Strategjia e zhvillimit të UMT-së.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e kërkimit e programit të doktoratës përputhet së paku me një nga fushat e veprimtarisë akademike të institucionit.	Fusha e kërkimit e programit të studimit përputhet plotësisht me një nga fushat kryesore të veprimtarisë akademike dhe kërkimore të Universitetit Metropolitan Tiranë. Institucioni ka një fokus të qëndrueshëm në fushat e shkencave kompjuterike, teknologjisë së informacionit, inteligjencës artificiale dhe automatizimit, të cilat janë

	<p>të përfaqësuara gjerësisht në programet ekzistuese të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>Në këtë kontekst, programi i doktoratës është një vijimësi logjike dhe e natyrshme e profilit akademik dhe kërkimor të institucionit, duke i dhënë mundësi zgjerimit të mëtejshëm të kompetencave shkencore në fushat e avancuara dhe ndërdisiplinore, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të institucionit. Për më tepër, stafi akademik dhe kapacitetet laboratorike ekzistuese në bashkëpunim edhe me universitetet ndërkombetare, sigurojnë një mbështetje solide për kërkimin shkencor në këtë fushë.</p> <p>Aneksi Nr. 11-Vendimi i Senatit për rregulloren e Doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i doktoratës ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij, të harmonizuara me ato të institucionit/institucioneve ofrues.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar mbi baza të qarta dhe të strukturuar, në përputhje të plotë me objektivat institucionale të zhvillimit akademik dhe kërkimor. Emërtimi i programit reflekton qartë fushën shkencore që trajtohet, ndërsa organizimi dhe struktura e tij janë të përcaktuara qartësisht në dokumentacionin përkatës akademik dhe institucional.</p> <p>Përmbajtja e programit është ndërtuar mbi module që mbulojnë aspektet teorike, metodologjike dhe praktike të inteligjencës artificiale dhe sistemeve inteligjente, duke përfshirë gjithashtu trajnim të avancuar në kërkimin shkencor dhe etikën e kërkimit. Qëllimi i programit është të përgatisë studiues të kualifikuar, të aftë për të zhvilluar kërkime origjinale dhe për të kontribuar në zhvillimin shkencor dhe teknologjik në fushat përkatëse.</p> <p>Objektivat e programit janë të harmonizuara ngushtë me misionin dhe strategjinë e institucionit për të nxitur ekselencën akademike, inovacionin teknologjik dhe kontributin e drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit përmes kërkimit të avancuar dhe ndërdisiplinor.</p> <p>Aneksi Nr. 01-Statuti UMT  Aneksi Nr. 05-Strategjia e zhvillimit UMT  Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit  Aneksi Nr. 11-Vendimi i Senatit për rregulloren e Doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i doktoratës hartohet dhe ofrohet me synimin për të nxitur zhvillimin shkencor ekonomik lokal dhe/ose kombëtar duke integruar në përmbajtje të tij strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar me një vizion të qartë për të kontribuar në zhvillimin shkencor, ekonomik dhe teknologjik të nivelit lokal dhe kombëtar. Programi reflekton prioritetet e përcaktuara në strategjitë kombëtare të zhvillimit, përfshirë Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Agjendën Dixhitale për Shqipërinë, duke promovuar një qasje të qëndrueshme dhe inovative në fushën e inteligjencës artificiale.</p> <p>Përmbajtja e programit është ndërtuar në mënyrë që të integrojë trendet më të fundit ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, duke u fokusuar në tematika si: inteligjenca artificiale e besueshme, etika në AI, sistemet e automatizuara, të mësuarit makinerik dhe përdorimet e AI në ekonomi, shëndetësi, energji dhe sektorin publik. Këto fusha janë</p>




	<p>me interes të drejtpërdrejtë për zhvillimin industrial dhe transformimin digjital të Shqipërisë.</p> <p>Në këtë mënyrë, programi nuk është vetëm një platformë për zhvillimin individual akademik, por një instrument strategjik për ndërtimin e kapaciteteve kombëtare kërkimore dhe inovative, në përputhje me interesin publik dhe qëllimet zhvillimore të vendit. Kjo përforcohet edhe nga lidhjet që Universiteti Metropolitan Tirana ka krijuar me industri vendase dhe organizata ndërkombëtare për projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore.</p> <p>01-Statuti UMT.pdf Aneksi Nr. 05-Strategjia e zhvillimit UMT Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 12-Reforma e kërkimit shkencor</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit është konceptuar në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të Universitetit Metropolitan Tirana, duke reflektuar fushat e tij prioritare akademike dhe kërkimore. Ai është i strukturuar qartë dhe i orientuar drejt nevojave kombëtare për zhvillim shkencor, duke integruar strategjitë kombëtare dhe trendet ndërkombëtare të kërkimit. Programi synon të krijojë kapacitete të avancuara përmes kërkimit shkencor me ndikim real në shoqëri dhe ekonomi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit i ciklit të tretë doktoratë synon të plotësojë nevojat aktuale dhe afatgjata që ka vendi për studiues dhe kërkues shkencorë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin e programit të doktoratës, institucioni, njësia përgjegjëse apo grupi kërkimor, kryen studime dhe analiza mbi situatën, zhvillimet, nevojat, prioritetet në fushën e përgjithshme dhe specifike të programit të doktoratës të cilat bëhen pjesë e projekt propozimit përpara hapjes së programit.</p>	<p>Bazuar në DVV, rezultojnë se institucioni UMT ka realizuar një studim paraprak të tregut duke u fokusuar në fushën e Inteligjences Artificiale, duke e parë si një mundësi shumë të mirë për të formuar kërkues shkencor në këtë fushë. Analiza e programit të doktoratës në “Inteligjenca Artificiale dhe Sisteme Inteligjente” është zhvilluar mbi bazën e analizave paraprake të zhvillimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e teknologjisë dhe AI-së. UMT ka analizuar nevojat emergjente të tregut vendas dhe rajonal për ekspertë të kualifikuar në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e teknologjive inteligjente, duke u mbështetur në dokumente strategjike kombëtare dhe në kërkime të tregut të punës, si dhe në konsultimet me aktorë të industrisë dhe akademisë.</p> <p>Aneksi Nr. 01-Statuti UMT Aneksi Nr. 13-Studimi i tregut për hapjen e programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i doktoratës ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e kërkuesve</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, diskutime me profesorët udhëheqës të studentëve, rezultojnë se ky program doktoratë ka objektiva të qarta që synojnë formimin e një profili të avancuar të kërkuesit</p>

<p>shkencorë me njohuri të thelluara shkencore, aftësi dhe kompetencat në fushën e kërkimit e zbatimit dhe në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi.</p>	<p>shkencor, të aftë për të kontribuar në mënyrë të pavarur dhe inovative në kërkimin shkencor, zbatimin teknologjik dhe zhvillimin e dijes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Objektivat janë në përputhje të plotë me nivelin 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe janë të fokusuara në zhvillimin e njohurive të thelluara teorike dhe praktike në fushën AI, sistemeve kompleks inteligjent, aftësive për analizë kritike dhe zgjidhje të problemeve komplekse në fushën e inteligjencës artificiale.</p> <p>Programi synon gjithashtu të përgatisë kërkues shkencorë që kuptojnë sfidat aktuale të vendit dhe janë të gatshëm të kontribuojnë në përparimin e sektorëve kyç të zhvillimit, si teknologjia, industria, energjia, shëndetësia dhe administrata publike. Përmbajtja e programit dhe trajnimet që ofrohen janë të ndërtuara në mënyrë që të mbështesin zhvillimin e kompetencave kërkimore, inovative dhe etike, si dhe të promovojnë ndërveprimin ndërdisiplinor dhe ndërkombëtar.</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i doktoratës hartohet dhe harmonizohet me programe të ngjashme të ofruar nga institucione partnere vendase apo të huaja, udhëzues, direktiva të BE, të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare me të cilat është partner apo bashkëpunon vendi ynë, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me modelet dhe standardet që aplikohen në programet homologe në universitetet evropiane, duke respektuar udhëzimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe direktivat e BE. Përmbajtja, struktura dhe rezultatet e pritshme të të nxënit janë të harmonizuara me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për nivelin 8, duke mundur krahasueshmëri dhe njohje ndërkombëtare të programit.</p> <p>Kjo qasje siguron që programi të jetë i integruar me prioritetet kërkimore ndërkombëtare dhe të lehtësojë bashkëpunimet me institucione partnere, si në fushën akademike ashtu edhe në projekte shkencore të përbashkëta. Gjithashtu, doktorantët përfitojnë nga mundësi për bashkëudhëheqje, mobilitet, dhe përfshirje në konsorciume kërkimore me mbështetje evropiane.</p> <p>Aneksi Nr.10-Rregullore e programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, mobilitetit dhe përfshirjen në veprimtaritë akademike të programit edhe të kërkuesve të huaj, programi i doktoratës mund të aplikohet pjesërisht ose i plotë edhe në gjuhën angleze.</p>	<p>Programi i doktoratës është i orientuar plotësisht drejt kërkimit shkencor ndërkombëtar, duke përmbushur plotësisht kërkesat për mobilitet akademik dhe ndërkombëtarizimin e UMT-se, si dhe në projekte shkencore.</p> <p>Të gjitha aktivitetet e kërkimit shkencor të zhvilluara nga doktorantët aktual janë realizuar në kuadër të projekteve kërkimore ndërkombëtare, duke përfshirë partneritete me institucione të arsimit të lartë dhe qendra kërkimi në vendet anëtare të BE-së dhe OECD-së. Këto bashkëpunime kanë krijuar mundësi reale për përfshirjen e kërkuesve të huaj në veprimtaritë e programit, si bashkëautor në artikuj shkencor, anëtarë të jurive të doktoraturës apo bashkëudhëheqës shkencorë.</p> <p>Gjuha angleze përdoret gjerësisht në publikimin e punimeve në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara, prezantimet në konferenca ndërkombëtare, si dhe aplikimin e doktorantëve për mobilitete, bursa dhe projekte kërkimore në kuadër të programeve si Erasmus+, Horizon</p>




	Europe, COST Action etj. Për pasojë, programi kontribuon në rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të kërkimit shkencor të realizuar në Shqipëri dhe rrit konkurrueshmërinë e vetë universitetit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Aneksi Nr.10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr.14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit përmbush në mënyrë të plotë kriteret e këtij standardi, duke reflektuar qartësisht nevojat aktuale dhe afatgjata të vendit për kërkues shkencorë. Programi është rezultat i analizave strategjike dhe përfshin objektiva të qarta, përmbajtje të harmonizuar me praktikën evropiane dhe një qasje të theksuar ndërkombëtare në zhvillimin akademik dhe kërkimor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programi i doktoratës organizohet në përputhje me fushën akademike të njësisë përgjegjëse për programin.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i doktoratës organizohet në nivel njësie bazë ose njësie kryesore të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe ecurinë e tij.	Njësia përgjegjëse për organizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike(DIK) pjesë e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT. Programi i doktoratës është organizuar në përputhje të plotë me fushën akademike të DIK-se, duke reflektuar qartësisht profilin shkencor dhe prioritetet akademike të saj. Ai zhvillohet në nivelin e njësisë bazë që disponon kapacitetet e nevojshme akademike dhe logjistike për të garantuar cilësinë dhe vazhdimësinë e programit. Përgjegjësia për mbarëvajtjen dhe ecurinë e programit është e qartë dhe e dokumentuar, duke siguruar mbështetjen institucionale dhe monitorimin e vazhdueshëm të tij. Aneksi Nr.10 - Rregullore e Programit të Studimit,
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse ka profilin, përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të doktoratës.	Njësia përgjegjëse(DIK) për programin e doktoratës zotëron një profil të mirëpërcaktuar akademik dhe shkencor, të ndërtuar mbi përvojën shumëvjeçare në ofrimin e programeve të ciklit të parë dhe të dytë në fushat e inxhinierisë kompjuterike, shkencave kompjuterike dhe inteligjencës artificiale. Struktura e saj përfshin staf akademik me përgatitje të lartë dhe tituj shkencorë, të angazhuar aktivisht në kërkimin shkencor dhe në projekte zhvillimore në përputhje me tematikën e programit të doktoratës. Mbështetja institucionale për realizimin e këtij programi është e dukshme nëpërmjet burimeve të dedikuara, si laboratorët bashkëkohorë dhe mjediset teknike të pajisura me teknologji të përshtatshme për zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e inteligjencës artificiale. Përdorimi i infrastrukturës së avancuar, bashkëpunimi me rrjete ndërkombëtare dhe qasja në literaturë shkencore të specializuar përforcojnë më tej kapacitetin e




	<p>njesisë për të ofruar një program të doktoratës të orientuar drejt cilësisë, inovacionit dhe kontributit në zhvillimin shkencor të vendit.</p> <p>Aneksi Nr. 39 – Lista e stafit akademik me kohë të plotë</p> <p>Aneksi Nr. 6 - Rregullore e FSHKIT</p> <p>Aneksi Nr. 66 – Lista e laboratoreve në përdorim të programeve që orfon FSHKIT</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të doktoratës është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</p>	<p>Instucioni ka kryer detyrimin ligjor duke rregjistruar këtë program stidimi, kodi i programit të studimit është 83DO0619A. Programi është konceptuar dhe strukturuar në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse, duke respektuar klasifikimin dhe kodifikimin zyrtar të programeve të studimit në nivel kombëtar dhe evropian. Tema dhe drejtimet e studimit të përfshira në program pasqyrojnë thelbin e veprimtarisë akademike të njësisë dhe përputhen me prioritetet kërkimore të saj.</p> <p>Përzgjedhja e fushës së doktoratës është bërë në bazë të analizës së kapaciteteve kërkimore të njësisë, përvojës së stafit dhe zhvillimeve bashkëkohore në shkencë dhe teknologji. Në këtë mënyrë, sigurohet që programi të jetë i harmonizuar me standardet evropiane të arsimit të lartë dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm shkencor dhe teknologjik, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit dhe nevojat e tregut.</p> <p>Aneksi Nr.10 - Rregullore e Programit të Studimit</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të doktoratës është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive përgjegjëse në institucionet respective.</p>	<p>Në këtë rast programi i doktoratës mbulohet plotësisht nga vetë departamenti në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera bazë të fakulteteve të tjera të UMT-së.</p> <p>Të gjitha njësitë bashkëpunuese kontribuojnë në përputhje me profilin e tyre shkencor dhe ekspertizën specifike, duke e pasuruar programin me një qasje ndërdisiplinore dhe duke garantuar një bazë solide për kërkimin shkencor të avancuar. Kjo qasje përforcon cilësinë dhe efektivitetin e programit, si dhe i përgjigjet nevojave akademike dhe kërkimore bashkëkohore, në përputhje me standardet institucionale dhe kombëtare.</p> <p>Shënime të takimeve.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i doktoratës është organizuar në përputhje të plotë me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë përgjegjëse, duke garantuar burime njerëzore dhe infrastrukturore të përshatshme për realizimin cilësor të tij. Fusha e programit është në harmoni me klasifikimet kombëtare dhe evropiane, ndërsa bashkëpunimi me njësi të tjera brenda institucionit forcon përmbajtjen akademike dhe qasjen ndërdisiplinore të programit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
----------------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------




## II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT DOKTORAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Organizimi i programit bazohet në rregullore dhe udhëzues të posaçëm të programit të doktoratës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e programit të doktoratës, përcakton në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit të doktoratës dhe i përditëson ato në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse që ofron programin e studimit është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT-së, Universiteti Metropolitan Tirana. Departamenti ka hartuar një kuadër të detajuar rregullator që mbulon të gjitha aspektet e funksionimit të tij. Rregullorja përcakton strukturën e programit, kriteret e pranimit, detyrimet e doktorantëve dhe udhëheqësve, si dhe procedurat për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe mbrojtjen e disertacionit. Ky kuadër përditësohet në mënyrë periodike, duke reflektuar zhvillimet shkencore, ndryshimet ligjore dhe kërkesat e tregut. Përditësimet e fundit, janë kryer në vitin 2024, të cilat kanë përfshirë praktika të avancuara ndërkombëtare, veçanërisht në monitorimin dhe vlerësimin e kërkimit. Përveç Rregullores së Doktoratës, janë miratuar edhe dokumente shtesë si Rregullorja e Etikës dhe e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës "Doktor". Të gjitha këto ndryshime janë miratuar konform statutit të UMT-së nga Senati Akademik. Programi mbështetet gjithashtu nga marrëveshje me universitete ndërkombëtare, që forcojnë komponentin kërkimor dhe nxisin ndërkombëtarizimin. Këto elemente dëshmojnë një angazhim të qartë për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 15 – Rregullore e Etikës së Doktoratës; Aneksi Nr. 16 – Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Elementët e organizimi të programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e tij dhe në akte të tjera të miratuara nga institucioni.</p>	<p>Elementët bazë të organizimit të programit të studimit, janë të përcaktuar në mënyrë të detajuar në rregulloren e programit dhe në aktet e tjera rregullatore të miratuara nga institucioni. Këto dokumente rregullojnë fazat e zhvillimit të programit – nga pranimi, ndjekja e studimeve dhe kërkimi shkencor, deri te mbrojtja e disertacionit – duke përcaktuar qartë detyrimet akademike dhe administrative që lidhen me secilën fazë.</p> <p>Përgjegjësitë institucionale janë të ndara ndërmjet fakultetit, departamentit, komisioneve akademike, udhëheqësve shkencorë, dhe koordinatorit dhe drejtorit të shkollës së doktoratës, me funksione të qarta në mbikëqyrjen dhe zbatimin e programit. Roli i drejtorit dhe koordinatorit të programit mbështetet në përvojë akademike të lartë dhe bashkëpunim të ndërsjellë, në përputhje me përvojat ndërkombëtare</p>

	<p>Gjithashtu, të drejtat dhe detyrimet e doktorantëve janë të formalizuara, duke garantuar qasje në mbështetje akademike, burime kërkimore dhe respektim të standardeve etike. Janë përcaktuar mekanizma për vlerësimin e disertacioneve, ndërsa përditësimi i dokumenteve rregullative është i parashikuar si proces i vazhdueshëm në funksion të zhvillimeve institucionale dhe kërkesave bashkëkohore të cilësisë.</p> <p>Kjo bazë dokumentare siguron funksionim të rregullt, transparencë dhe përafrim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p>Aneksi Nr. 15 – Rregullore e Etikës së Doktoratës;  Aneksi Nr. 16 – Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor;  Aneksi Nr. 17 – Vendimi i Senatit për Rregulloren e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës Doktor;  Aneksi Nr. 18 - Vendim i Senatit për rregulloren e Etikës së Doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse harton dhe miraton manuale, udhëzues ose modele që shërbejnë si shembuj me elementët që duhet të përmbajë projekt propozimi.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike(DIK), si njësia përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e programit të doktoratës, ka hartuar dhe miratuar një sërë dokumentesh rregullative dhe udhëzuese që mbështesin procesin akademik dhe kërkimor. Ndër to përfshihen: Rregullorja e programit të studimit, Rregullorja e Etikës së Doktoratës, Udhëzuesi për kontrollin e plagjiaturës, si dhe modele orientuese për përgatitjen e projekt-propozimit të disertacionit. Këto modele përmbajnë elementët thelbësorë të një propozimi të plotë, si titulli, fusha/nënfusha e kërkimit, objektivat, motivimi, kuadri teorik, qasja ndaj problemit, aplikimet e mundshme, bibliografia, fazat e zbatimit dhe mënyrat e vlerësimit të rezultateve, përfshirë edhe kontaktet referuese jashtë institucionit.</p> <p>Dokumentet ofrojnë udhëzime të qarta dhe praktike për kandidatët, duke përcaktuar formatin dhe përmbajtjen që kërkohet për projektet kërkimore dhe disertacionet. Krahas kësaj mbështetjeje, kandidatët asistohen edhe nga Koordinatorin e doktoratës, i cili i udhëzon dhe sqaron për çdo paqartësi gjatë hartimit të projekt-propozimit.</p> <p>Aneksi Nr.15 - Rregullore e Etikës së Doktoratës;  Aneksi Nr. 28 - Udhëzues për kontrollin e plagjiaturës</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse harton dhe miraton udhëzues, modele për raportimin, vlerësimin dhe arritjet e doktorantëve gjatë gjithë vitit akademik dhe të studimeve.</p>	<p>DIK si njësia përgjegjëse për programin e doktoratës, ka hartuar dhe miratuar dokumente orientuese që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë akademike dhe kërkimore të doktorantëve gjatë gjithë vitit akademik. Në këtë kuadër, është adoptuar një model raportimi vjetor i bazuar në praktikën e universiteteve partnere evropiane, i cili përfshin një sërë elementësh thelbësorë: përshkrimi i progresit të punës kërkimore, vlerësimi i kushteve në të cilat po zhvillohet puna për disertacionin, përfshirja në veprimtari formuese, identifikimi i pikave të forta dhe vështirësive të hasura, si dhe një vlerësim përfundimtar nga ana e oponentit të jashtëm.</p>




	<p>Gjithashtu, është përgatitur dhe miratuar një formular i detajuar për raportimin e progresit të doktorantëve, i cili duhet plotësuar në fund të çdo viti akademik. Ky dokument përfshin përmbledhjen e punës vjetore nga vetë doktoranti, një pasqyrë të takimeve dhe diskutimeve me udhëheqësin shkencor, si dhe një vlerësim të ecurisë së doktorantit të përgatitur nga vetë udhëheqësi. Të gjitha këto instrumente shërbejnë për të siguruar një ndjekje sistematike të punës së doktorantëve, për të identifikuar në kohë nevojat për mbështetje dhe për të garantuar standarde të larta akademike në realizimin e studimeve të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 54 – Model vlerësimi i Oponentit të jashtëm;  Aneksi Nr. 24 – Formulari i raportit të progresit për studentët e doktoratës.</p> <p>Dok shtese: A2 Formati mbi vlerësimin e oponencës; A3 Formati specifik i vlerësimit për doktorantët</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse harton dhe miraton udhëzues për hartimin e disertacionit, referimeve, prezantimeve, kontrollit të plagjiaturës.</p>	<p>DIK ka hartuar dhe miratuar një sërë dokumentesh udhëzuese që ndihmojnë doktorantët në procesin e hartimit dhe paraqitjes së disertacionit, si dhe në respektimin e standardeve të integritetit akademik. Në funksion të standardizimit të dokumenteve të doktoraturës, është përgatitur një template në formatin LaTeX për hartimin e disertacionit, e cila përfshin të gjithë elementët thelbësorë të strukturës shkencore: hyrjen, sfondin e problemit, përmbledhjen e literaturës, qasjen e propozuar, implementimin dhe rezultatet, optimizimet, diskutimin dhe përfundimet, referencat dhe anekset. Për të njëjtën qëllim është përgatitur edhe një template për prezantimet vjetore të progresit të punës kërkimore të doktorantëve, e cila ndihmon në strukturimin dhe paraqitjen efektive të të dhënave dhe rezultateve të arritura gjatë vitit akademik. Ky model përfshin elementë si titulli i plotë, të dhënat e doktorantit dhe udhëheqësit, hyrja, objektivat, metodologjia, rezultatet dhe përfundimet.</p> <p>Edhe për kontrollin e plagjiaturës, UMT ka miratuar “Rregulloren e Etikës së Doktoratës” si dhe një udhëzues të detajuar për kontrollin e plagjiaturës. Këto dokumente u vihen në dispozicion doktorantëve që në fillim të marrëdhënies me institucionin, së bashku me kontratën e shërbimit. UMT përdor platformën e njohur Turnitin për detektimin e plagjiaturës dhe ka realizuar trajnime specifike për përdorimin e saj, për të siguruar që doktorantët dhe stafi akademik janë të njohur me procedurat dhe funksionalitetet e këtij sistemi</p> <p>Aneksi Nr. 25 – Template për hartimin e disertacionit  Aneksi Nr. 26 – Template për prezantime  Aneksi Nr. 74 - Trajnimi online mbi sistemin antiplagjiaturë</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni dhe njësia përgjegjëse harton tregues të matshëm lidhur me plagjiaturën bazuar në fushën e kërkimit dhe studimit, si dhe referenca lidhura me to duke u kujdesur që niveli i ngjashmërisë së disertacionit dhe</p>	<p>UMT dhe njësia bazë DIK, ka të përcaktuar qartësisht në dokumentet rregullative të programit të doktoratës masat dhe treguesit për matjen e ngjashmërisë së punimeve, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të plagjiaturës. Në Rregulloren e Programit të Studimit janë përfshirë nene specifike që adresojnë plagjiaturën, duke e lidhur atë ngushtë me parimet e integritetit akademik.</p>




punimeve shkencore të doktorantit të jenë nën 30%.	<p>Kontrolli i plagjiaturës kryhet në mënyrë të detyrueshme përpara vlerësimit të disertacionit nga Departamenti. Procesi fillon me verifikimin e punimit nga Dekani, i cili e kalon disertacionin përmes sistemit antiplagjiaturë Turnitin, për të vlerësuar përqindjen e ngjashmërisë. UMT ka vendosur pragun maksimal të pranueshëm të ngjashmërisë në 30%, nivel i cili konsiderohet si i lejueshëm në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe natyrën e fushës shkencore. Në rastet kur ngjashmëria kalon përqindjen e lejuar, institucioni vepron konform dispozitave të përcaktuara në Rregulloren e Etikës së Doktoratës, e cila parashikon hapat dhe masat që duhen marrë. Gjithashtu, janë hartuar edhe udhëzues të posaçëm për kontrollin e plagjiaturës që shërbejnë si orientim praktik për kandidatët ndërsa Rregullorja e Fakultetit FSHKIT i mbështet këto masa me dispozita të veçanta. Këto rregulla garantojnë që çdo produkt shkencor i doktorantëve të respektojë standardet më të larta të ndershmërisë akademike.</p> <p>Aneksi Nr. 15 - Rregullore e Etikës së Doktoratës; Aneksi Nr. 28 - Udhëzues për kontrollin e plagjiaturës</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UMT ka hartuar dhe miratuar dokumentacion të plotë dhe udhëzues praktikë që mbulojnë të gjitha etapat e formimit të doktorantëve – nga propozimi i projektit, vlerësimi dhe raportimi vjetor, deri te disertacioni përfundimtar dhe kontrolli i plagjiaturës. Institucioni ka vendosur tregues të qartë dhe masa të matshme për garantimin e cilësisë dhe integritetit akademik, duke ofruar mbështetje të strukturuar përmes koordinimit, dokumenteve zyrtare dhe sistemeve të specializuara.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Përmbajtja e programit të doktoratës organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në udhëzues të hapësirës evropiane në arsimin e lartë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i doktoratës mund të përmbajë si pjesë të tij, lëndë të formimit teorik deri në 30 ECTS të cilat realizohen në vitin e parë të programit.</p>	<p>Departamenti dhe profesorët përgjegjës në këtë program studimi kanë gjykura të mos përfshijnë pjesë të formimit teorik. Ky program nuk përfshin lëndë teorike. Duke parë që doktorantët e rregjistruar ishin edhe staf efektiv i UMT-se, por nëse do të rritej numri doktorantëve mund edhe të parashikohen lënde teorike. Kjo do të ndihmonte doktorantët në formimin e tyre me të mirë drejt sistemeve AI.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Kohëzgjatja e normale e programit të doktoratës është 3 deri në 5 vite akademike dhe jo më shumë se dyfishi i kohës normale të saj.</p>	<p>Afati kohor i programit të doktoratës është përcaktuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar kufizimet prej jo më pak se 3 vite dhe jo më shumë se 5 vite akademike. Këto afate janë të qarta në rregulloren e studimeve, konkretisht në Nenin 16, duke garantuar një kohëzgjatje të përshtatshme për realizimin cilësor të studimeve dokorale.</p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja e programit, organizimi, vlerësimi dhe monitorimi përafrohen me shembuj të ngjashëm në institucione ndërkombëtare të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.</p>	<p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit</p> <p>Programi i studimit është konceptuar dhe zbatuar në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (European Higher Education Area – EHEA), duke synuar përafrimin maksimal me praktikat më të mira të institucioneve ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor. Organizimi, përmbajtja, mënyrat e vlerësimit dhe monitorimit të programit janë të ndërtuara mbi përvojat e universiteteve partnere evropiane dhe amerikane, duke mundësuar një model bashkëkohor dhe të krahasueshëm ndërkombëtarisht.</p> <p>Një element thelbësor i këtij përafrimi është përfshirja e personaliteteve akademike nga universitete të huaja në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës “Doktor”, të cilët luajnë një rol këshillues dhe monitorues, duke garantuar respektimin e standardeve shkencore ndërkombëtare. Gjithashtu, drejtimi i Shkollës së Doktoratës i është besuar një Profesori me eksperiencë në kërkimin shkencor në universitetin ESIEE- France, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së procesit akademik dhe kërkimor.</p> <p>Doktorantët zhvillojnë veprimtarinë e tyre kërkimore në UMT dhe/ose pranë institucioneve partnere ndërkombëtare, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke krijuar një ambient akademik ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirës. Vlerësimi i ecurisë së tyre gjatë viteve të studimit është ndërtuar sipas modeleve të universiteteve bashkëpunuese, duke garantuar një proces transparent, objektiv dhe të krahasueshëm në nivel ndërkombëtar.</p> <p>Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës;  Aneksi Nr. 19-Emërimi i drejtorit të shkollës së Doktoratës;  Aneksi Nr. 29 - Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës Doktor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Nëse programi i doktoratës përfshin formimin teorik, lëndët fokusohen në strukturimin e kërkimit shkencor të thelluar, metodave cilësore dhe sasiore të përpunimit të të dhënave, etikës së kërkimit shkencor dhe shkrimit të punimeve shkencore e të disertacionit të doktoratës.</p>	<p>Nuk janë parashikuar lëndë teorike në këtë program doktorate.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Nëse programi i doktoratës përfshin formimin teorik, lëndët përmbajnë njohuri të avancuara të debateve teorike, përqsasjeve kërkimore, bashkëpunimeve ndërdisiplinore dhe zhvillimeve të fundit të fushës shkencore të doktorantit.</p>	<p>Nuk janë parashikuar lëndë teorike në këtë program doktorate.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Kur aplikohet, lëndët e formimit teorik të doktoratës vlerësohen me provim/e teorik në</p>	<p>Nuk janë parashikuar lëndë teorike në këtë program doktorate.</p>

fushën përkatëse të studimeve, të organizuar nga personeli akademik i programit. Procedura e vlerësimit të njohurive të formimit teorik, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e programit të doktoratës.									
<b>Kriteri 7.</b> Në kuadër të përmirësimit të programit, njësia përgjegjëse ka të drejtën e ndryshimeve në përmbajtje të formimit teorik të programit të doktoratës, dokumenton procedurën dhe informon ministrinë përgjegjëse për arsimin.	Nuk janë parashikuar lëndë teorike në këtë program doktorate.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i doktoratës është i hartuar dhe organizuar në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe udhëzuesit e EHEA, duke siguruar një qasje të unifikuar dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Përmbajtja, struktura dhe procedurat e tij respektojnë standardet akademike dhe kërkimore bashkëkohore, duke garantuar cilësi dhe transparencë në të gjitha fazat e ciklit të doktoratës.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i doktoratës organizohet bazuar në projekte kërkimi dhe zhvillimi dhe harmonizohet me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe prioritetet e kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i doktoratës është pjesë e politikës institucionale të zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndërtohet në formën e një projekti afatgjatë kërkimi dhe zhvillimi në fushën e caktuar.	<p>Programi i studimit është ndërtuar si një projekt afatgjatë kërkimi dhe zhvillimi, që mbështet drejtpërdrejt politikën institucionale për fuqizimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Kërkimi shkencor në UMT konsiderohet një komponent thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit dhe është materializuar në krijimin e strukturave si Qendra e Inovacionit, Inkubatori i Biznesit dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Programi është në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare në fushat prioritare si inteligjenca artificiale, robotika, energjia dhe teknologjitë mjekësore, duke sjellë një qasje ndërdisiplinore dhe duke kontribuar në zgjidhjen e sfidave komplekse teknologjike dhe sociale. Përmes këtij programi promovohet bashkëpunimi midis stafit akademik dhe institucioneve partnere, duke krijuar rrjete shkëmbimi njohurish dhe projektesh kërkimore.</p> <p>Si rezultat, programi i doktoratës jo vetëm që është në harmoni me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit, por edhe ndihmon në pozicionimin e institucionit si një lider në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në nivel kombëtar e më gjerë.</p>

	<p>Aneksi Nr. 5 - Strategjia e zhvillimit UMT;  Aneksi Nr. 77 - Metropolitan Innovation Center Grant Agreement;  Aneksi Nr. 72 - Lista e projekteve të fituara</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Projekti i doktoratës mund të hartohet me iniciativë individuale nga personeli akademik, nga grupi kërkimor i njësisë bazë, nga institucioni apo si propozim nga partnerë të jashtëm me të cilët institucioni bashkëpunon.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit rezulton se projekti i doktoratës mund të lindë si iniciativë individuale e personelit akademik, si pjesë e një grupi kërkimor të njësisë bazë, apo në bashkëpunim me partnerë të jashtëm. Kjo qasje fleksibël nxit zhvillimin e ideve kërkimore të bazuara në nevojat e tregut dhe prioritetet shkencore, duke e bërë programin të hapur ndaj dinamikave bashkëkohore të kërkimit. Projekti zhvillohet si një aktivitet kërkimor i strukturuar, në të cilin studenti bashkëpunon ngushtësisht me udhëheqësin shkencor dhe me grupet kërkimore të brendshme dhe të jashtme, në përputhje me objektivat e shkollës doktorale.</p> <p>Aneksi Nr. 10 – Rregullore e programit të studimit;  Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha kryesore dhe specifike e hulumtimit/kërkimit përzgjidhet në mënyrë të tillë që të jetë pjesë e fushës së studimeve të njësisë përgjegjëse.</p>	<p>Fushat kryesore dhe specifike e kërkimit të programit janë zgjedhur në përputhje të plotë me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë përgjegjëse DIK. Fokusimi në fusha si inteligjenca artificiale e aplikuar në mjekësi, energjetikë, robotikë, siguri kibernetike dhe transport inteligjent, siguri etj., reflekton ekspertizën dhe drejtimet strategjike të kërkimit të këtij departamenti.</p> <p>Këto nënfusha janë të mbështetura institucionalisht dhe janë pjesë integrale e strukturës dhe objektivave të programit doktorale, duke garantuar kështu një bazë të qëndrueshme akademike dhe shkencore për zhvillimin e kërkimeve cilësore dhe të qëndrueshme.</p> <p>Aneksi Nr. 10 – Rregullore e programit të studimit;  Aneksi Nr. 30 – Propozim-vendim temash dhe udhëheqësish</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Projekt propozimi i njësisë përgjegjëse, shqyrtohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e studimeve doktorale rezulton se propozimi i projektit të doktoratës kalon në një proces të qartë dhe të strukturuar miratimi, ku pas shqyrtimit fillestar nga Departamenti dhe aprovimit nga Dekani, i paraqitet Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës “Doktor”. Ky komision, i përbërë nga ekspertë të fushës, ka detyra dhe përgjegjësi të qarta të përcaktuara në rregullore, duke garantuar cilësinë dhe përputhshmërinë akademike të projektit me standardet institucionale dhe shkencore.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit, neni 3.1;  Aneksi Nr. 16 - Rregullore e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kandidati që kërkon të pranohet në programin e studimeve të doktoratës harton projektin individual për një fushë të veçantë kërkimi e cila përfshihet në projektin e doktoratës dhe e analizon atë gjerësisht në dokumentet e aplikimit.</p>	<p>Kandidatët që aplikojnë në programin e doktoratës hartojnë projekte individuale kërkimore në fusha të veçanta, të cilat janë të bazuara në projektet më të gjera dhe strategjike të miratuara nga Departamenti. Këto projekte individuale përbëjnë një komponent kyç të dokumentacionit të aplikimit dhe analizohen në detaje për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe potencialin kërkimor të kandidatëve.</p> <p>Procesi i vlerësimit përfshin prezantimin dhe diskutimin e projektit përballë një komisioni ad-hoc, të përbërë nga ekspertë të emëruar nga</p>

	<p>Rektori i UMT. Ky komision ka për detyrë të sigurojë që projektet individuale të jenë në përputhje me objektivat e programit dhe standardet shkencore, duke garantuar cilësinë dhe seriozitetin e studimeve doktorale. Procedura është konform rregullores dhe u njoftohet kandidatëve para aplikimit.</p> <p>Aneksi Nr. 32 - Projekt propozimet individuale brezi parë;  Aneksi Nr. 33 – Projekt propozimet individuale brezi i dytë;  Aneksi Nr. 34 - Komisionet ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i doktoratës rezulton të jetë i ndërtuar mbi projekte kërkimi dhe zhvillimi, duke u integruar ngushtësisht me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor. Ai përfaqëson një qasje strategjike të institucionit për të nxitur inovacionin dhe avancimin teknologjik në fusha me rëndësi të veçantë për zhvillimin e vendit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Kriteret e aplikimit përzgjedhjes dhe pranimit të kandidatëve përcaktohen nga njësia përgjegjëse e cila garanton transparencë në zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës, përcakton kriteret e aplikimit lidhur me gjuhën/gjuhët e huaja, mesataren e pranimit, fushën e studimit dhe programet e studimit të cilët pranohen si kandidatë, dokumentet e aplikimit etj. dhe i bën ato publike.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program doktoral, DIK ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të strukturuar kriteret e aplikimit për pranimin e kandidatëve. Këto kriteret përfshijnë fushën përkatëse të studimeve, mesataren e pranimit (<math>\geq 8</math>), zotërimin e diplomës së ciklit të parë dhe të dytë ose të një diplome të integruar në fushën e shkencave të aplikuara, si dhe dëshminë për njohuritë në gjuhë të huaja (anglisht dhe mundësisht frëngjisht), duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe rregulloren përkatëse të programit.</p> <p>Gjithashtu, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është i detajuar dhe i publikuar në faqen zyrtare të UMT, çka garanton transparencë dhe barazi në përzgjedhjen e kandidatëve. Dosja personale e çdo aplikanti ruhet pranë departamentit dhe sekretarisë mësimore, duke mundësuar verifikimin dhe gjurmueshmërinë e çdo faze të përzgjedhjes. Kjo qasje ndihmon në forcimin e besueshmërisë dhe integritetit të procesit të pranimit në programin e doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 10 – Rregullore e programit të studimit;  Aneksi Nr. 35 - Lista e dokumentave të dosjes personale të aplikantëve doktorant  <a href="https://umt.edu.al/shkolla-e-doktoratures-dhe-phd/">https://umt.edu.al/shkolla-e-doktoratures-dhe-phd/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në programet e doktoratës aplikojnë dhe pranohen kandidatët e punësuar si personel akademik në institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë, si personel kërkimor në një</p>	<p>Programi i doktoratës parashikon mundësinë e aplikimit dhe pranimit të kandidatëve që janë të punësuar si personel akademik në UMT ose në institucione të tjera të arsimit të lartë, si dhe të personelit kërkimor në institucione kërkimore. Pranimi i tyre bëhet nëse ata plotësojnë të gjitha kriteret ligjore dhe specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit të doktoratës.</p>




<p>institucion kërkimor dhe që plotësojnë kriteret ligjore e ato specifike të përcaktuara në programin e studimit.</p>	<p>Kjo praktikë është në përputhje me objektivat e avancimit të kapaciteteve kërkimore dhe akademike të stafit, duke garantuar përfshirjen e individëve të kualifikuar që kontribuojnë në zhvillimin shkencor të institucioneve të arsimit të lartë dhe të kërkimit në vend. Aktualisht të gjithë kandidatet janë të punësuar si staf akademik efektiv në UMT.</p> <p>Aneksi Nr. 37 - Lista e studentëve doktorant; Aneksi Nr. 39 - Lista e stafit akademik me kohë të plotë; Aneksi Nr. 40 - Model kontrate pune doktoranti</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kandidatët që aplikojnë për të vazhduar programin e doktoratës dëshmojnë se kanë njohuri të thelluara teorike në fushën përkatëse të studimit, aftësi dhe kompetenca si të menduarit krijues, aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore, kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të doktoratës përcakton qartë kriteret e pranimit të kandidatëve, duke vlerësuar njohuritë teorike të thelluara dhe aftësitë e tyre për mendim krijues dhe zgjidhje problemesh në fushën përkatëse të studimit. Institucioni ka përcaktuar edhe mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, duke theksuar rezultatet e dy cikleve akademike si dhe prezantime projektit. Preferohen kandidatët me background në Shkencat Kompjuterike, Inxhinierinë Kompjuterike, Matematikën e Aplikuar dhe fusha të ngjashme, ndërsa procesi i aplikimit përfshin faza të ndryshme, përfshirë intervista ku vlerësohen kompetencat kritike dhe krijuese, si dhe përshtatshmëria me kërkesat specifike të fushës së kërkimit. Kjo qasje siguron përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm për të zhvilluar projekte kërkimore cilësore dhe inovative.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit, neni 11.1, 11.2, 11.4; Aneksi Nr. 35 - Lista e dokumentave të dosjes personale të aplikantëve doktorant; Aneksi Nr. 43-Kriteret për vlerësimin e kandidatëve doktorant.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse miraton projektet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato drejtime, fusha e të cilave përfshihet në fushën e programit të miratuar të doktoratës që ajo ofron.</p>	<p>DIK, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për programin e doktoratës, shqyrton dhe miraton vetëm ato projekt-propozime kërkimore individuale që përputhen me fushat, nënfushat dhe objektivat e përcaktuara në programin e studimit të miratuar. Kjo siguron që kërkimi i doktorantëve të jetë i orientuar drejt zhvillimeve prioritare në fusha strategjike si Inteligenca Artificiale, siguria kibernetike, energjia dhe transporti inteligjent. Një aspekt thelbësor që merret parasysh është përputhja etike dhe respektimi i pronësisë intelektuale, që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe legjitimitetin e kërkimit shkencor. Kjo qasje e strukturuar forcon integritetin akademik dhe garanton koherencën midis objektivave të institucionit dhe projekteve kërkimore individuale.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 32 - Projekt propozimet individuale, brezi i parë; Aneksi Nr. 33 - Projekt propozimet individuale brezi i dytë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse miraton kriteret shtesë pranimit si intervista, referenca, testim ose provime si dhe dokumente të tjera shtesë të bëra publike paraprakisht.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes se vetëvlerësimit nuk rezulton se DIK të këtë aplikuar kriteret shtesë pranimit për programin e doktoratës. Kriteret formale si nota mesatare apo zotërimi i gjuhëve të huaja, kandidatët vlerësohen përmes intervistave, referencave akademike, prezantimit të motivimit dhe analizës së kompetencave ndërdisiplinore (cross-</p>

	skills) janë të cilësuara në rregulloren përkatës të studimit doktoral. Këto kritere janë të dokumentuara dhe të publikuara paraprakisht, duke garantuar transparencë dhe barazi në procesin e përzgjedhjes. Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 43 - Kriteret për vlerësimin e kandidatëve doktorant.				
<b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse përcakton kriteret specifike që kandidati duhet të plotësojë për të transferuar studimet në programin e studimit, sipas fushës së kërkimit dhe i bën ato publike paraprakisht	Nuk ka patur raste të transferimit të studimeve në këtë program doktoral. Instucionioni UMT nëpërmjet statutit dhe rregullores së brendshme e tij përcaktojnë qartë sipas ligjislacionit në fuqi kriteret ku kandidatët duhet të plotësojnë për të transferuar studimet në këtë program studimi. Aneksi Nr. 1 - Statuti UMT; Aneksi Nr. 2 - Rregullore e brendshme UMT				
<b>Kriteri 7.</b> Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia përgjegjëse bazuar në analizë të mirëfilltë të kapaciteteve pritëse të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe bëhen publike.	Aktualisht janë 8 student doktoral të rregjistruar, konkretisht 3 në vitin akademik 2022-2023 dhe 5 student në 2023-24. Kuotat minimale dhe maksimale të pranimit miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit dhe më pas certifikohen nga Ministria e Arsimit. Procesi i përcaktimit të numrit të doktorantëve është bazuar në kriteret ligjore dhe standardet institucionale, si dhe bëhet publik përmes kanaleve zyrtare të universitetit. Kjo siguron një balancë të drejtë midis kërkesës për studime doktorale dhe burimeve të disponueshme për realizimin cilësor të tyre. Numri i studenteve doktoral është në përputhje me numrin maksimal që udhëheqësi mund të te ndjek sipas gradës akademike. Aneksi Nr. 41 - VSA dhe VBA për kuotat dhe udhëheqësit e doktoratës; Aneksi Nr. 42 - Numri i kuotave të doktorantëve i certifikuar nga MAS				
<b>Kriteri 8.</b> Studimet e doktoratës zhvillohen pranë njësisë përgjegjëse si pjesë e projektit kërkimor shkencor të aprovuar dhe me financim të siguruar nga burimet financiare të institucionit apo projektit.	Studimet e doktoratës zhvillohen në UMT si dhe në institucionet partnere, si pjesë e projekteve kërkimore të miratuara nga departamenti DIK. Institucioni kishte mbështetur disa mobilitete disa mujore për disa studentë në formën e projekteve. Financimi i këtyre projekteve është i siguruar nga burimet institucionale të UMT, e cila aktualisht mbulon 100% tarifat e doktoratëve përmes bursave, duke vendosur kritere për përzgjedhje në rastet e konkurrencës së lartë. Për përfitimin e financimit, lidhet një marrëveshje kontraktuale ndërmjet doktorantit dhe institucionit, duke përcaktuar detyrimet dhe kontributin e mëvonshëm të doktorantit në UMT. Aneksi Nr. 27 - Kontratë shërbimi e doktorantit; Aneksi Nr. 45 - Aneks kontratë shërbimi e doktorantit; Aneksi Nr.71-Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi doktoral siguron një përzgjedhje cilësore të kandidatëve dhe zhvillimin e studimeve mbi baza të qarta akademike, etike dhe institucionale. Ai mbështetet në projekte kërkimore të harmonizuara me prioritetet kombëtare, me financim të siguruar dhe transparencë në përzgjedhje, duke u mundësuar doktorantëve zhvillimin profesional dhe kontributin e tyre në zhvillimin shkencor të vendit.</i>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo doktorant nga aplikimi, pranimi deri përfundim të studimeve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve në fazën e aplikimit.	Gjate vizitës në institucion u evidentua se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike(DIK) dhe Sekretaria Mësimore pranë Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT-së në UMT administrojnë në mënyrë të plotë dokumentacionin e aplikantëve për programin e doktoratës, si në formë elektronike ashtu edhe fizike. Ky proces është i rregulluar nga dispozitat përkatëse në Rregulloren e programit dhe ruhet në përputhje me procedurat e përcaktuara. Dokumentacioni shqyrtohet fillimisht nga Departamenti dhe më pas nga Komisioni ad-hoc. Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit, neni 4.3, 6.1, 6.2; Aneksi Nr. 35 - Lista e dokumentave të dosjes personale të aplikantëve doktorant. Evidentimi gjate vizitës në institucionin UMT.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes të kandidatëve aplikantë dhe fitues dhe garanton transparencë në vendimmarrje e proceset e ankimimit.	DIK, si njësi bazë përgjegjëse për programin e doktoratës, administron në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar procesin e përzgjedhjes dhe vendimmarrjes për kandidatët aplikantë dhe fitues. Dokumentacioni mbahet si në formë elektronike ashtu edhe në letër dhe përfshin vendimet e Komisionit Ad Hoc, listat përfundimtare dhe paketat përkatëse për çdo brez kandidatësh. Gjithashtu, garantojen transparenca dhe të drejtat e ankimimit sipas Statutit dhe Rregullores së brendshme të UMT-së. Aneksi Nr. 1 – Statuti UMT; Aneksi Nr. 2 – Rregullore e brendshme UMT Aneksi Nr. 46 - Paketa e përzgjedhjes dhe vendimmarrjes së kandidatëve brezi i parë; Aneksi Nr. 47 - Paketa e përzgjedhjes dhe vendimmarrjes së kandidatëve, brezi i dytë
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër të dhënat e çdo doktoranti në lidhje me veprimtaritë akademike dhe kërkimore shkencore të tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve.	DIK, në përputhje me rregulloren e programit të doktoratës, mban për secilin doktorant një portofol të plotë dhe të strukturuar, në format elektronik dhe të printuar, që dokumenton të gjitha veprimtaritë akademike dhe kërkimore gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve. Ky portofol përfshin planin vjetor dhe raportin përkatës të veprimtarive formuese dhe kërkimore, të cilat pasqyrojnë angazhimet akademike, pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, zhvillimin e moduleve formuese, si dhe progresin në drejtim të realizimit të tezës së doktoratës. Gjithashtu, dokumentohen punimet dhe publikimet shkencore të doktorantit, raportet e punës kërkimore të secilit vit akademik për secilin brez doktorantësh. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për vlerësimin periodik të progresit të doktorantit dhe përbëjnë një

	<p>element thelbësor të procesit të monitorimit dhe cilësisë së studimeve të doktoratës.</p> <p>Administrimi i këtij dokumentacioni garanton gjurmueshmërinë e plotë të aktivitetit akademik dhe shkencor të doktorantëve, duke siguruar transparencë dhe koherencë me kërkesat ligjore dhe institucionale.</p> <p>Aneksi Nr. 62 - Modeli i planit të veprimtarive formuese dhe kërkimore; Aneksi Nr. 63 - Modeli i raportit vjetor i veprimtarive formuese dhe kërkimore).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër raportimet, komunikimet zyrtare, raportet e vlerësimit të ecurisë dhe të progresit të doktorantit.</p>	<p>DIK administron në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar, në format elektronik dhe të printuar, të gjitha raportimet dhe komunikimet zyrtare që lidhen me ecurinë dhe progresin e doktorantëve gjatë studimeve.</p> <p>Këto përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet dhe raportet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore të secilit doktorant.</li> <li>• Komunikimet zyrtare mes udhëheqësve shkencorë dhe doktorantëve, si dhe dokumentacionin përkatës për konsultimet dhe udhëzimet e dhëna gjatë procesit të studimeve.</li> <li>• Vlerësimet e oponentëve të jashtëm dhe ato të vetë DIK-së për ecurinë vjetore të doktorantit dhe vendimet për kalimin nga një vit studimi në tjetrin .</li> </ul> <p>Këto dokumente mbahen si pjesë e portofolit të doktorantit dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin cilësor të progresit akademik dhe shkencor. Kjo praktikë siguron transparencë, gjurmueshmëri dhe përputhshmëri me kërkesat e rregullores së programit të doktoratës dhe standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.</p> <p>Aneksi Nr. 53 - Vlerësime, komente, komunikime udhëheqës-doktorant; Aneksi Nr. 55 - Vlerësimi i ecurisë vjetore nga Departamenti;</p> <p>Aneksi Nr. 58 - Vlerësimi i Oponentëve të jashtëm.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse ve në dispozicion të studentëve sistemin elektronik antiplagjiaturë si dhe mekanizma tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale.</p>	<p>UMT i kushtonte një rëndësi të veçantë respektimit të etikës në kërkimin shkencor dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale, veçanërisht në fushat e teknologjisë së informacionit dhe inteligjencës artificiale, ku sfidat në këtë aspekt janë të theksuara.</p> <p>Në kuadër të programit të doktoratës, DIK vinte në dispozicion të doktorantëve sistemin elektronik antiplagjiaturë Turnitin, i cili përdoret për verifikimin e punimeve shkencore, përfshirë raportet e veprimtarive, publikimet dhe tezën përfundimtare. Për përdorimin e këtij sistemi, doktorantëve u ofrohet një udhëzues i detajuar që përfshin sqarime mbi shkallën e përgjithshme të ngjashmërisë dhe përqindjen e ngjashmërisë me një burim të vetëm. Afati i përdorimit të platformës përfundon me 1 Shtator 2025. Gjithashtu, Rregullorja e Etikës së Doktoratës përcakton qartë parimet e integritetit akademik dhe mekanizmat e vetëkontrollit për të parandaluar çdo formë të</p>




	<p>plagjiaturës. Këto masa përbëjnë një mbështetje të strukturuar për doktorantët në respektimin e standardeve etike dhe sigurimin e cilësisë së kërkimit shkencor.</p> <p>Aneksi Nr.15 - Rregullore e Etikës së Doktoratës; Aneksi Nr. 28 - Udhëzues për kontrollin e plagjiaturën; Aneksi Nr. 31 - Sistemi antiplagjiaturë Turnitin</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse harton në mënyrë periodike raportime mbi ecurinë e programit të doktoratës dhe studentëve individualisht dhe informon Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.</p>	<p>DIK ka zbatuar një sistem të strukturuar të raportimit periodik për ecurinë e programit të doktoratës dhe për progresin individual të doktorantëve. Këto raportime janë pasqyruar për dy vite akademike 2022-23 dhe 2023-24 dhe përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore,</li> <li>• Raportet vjetore që dokumentojnë realizimin e këtyre veprimtarive,</li> <li>• Vlerësime dhe komunikime ndërmjet udhëheqësve shkencorë dhe doktorantëve, që dokumentojnë progresin, komentet dhe rekomandimet,</li> <li>• Vlerësimin e ecurisë vjetore të secilit doktorant nga Departamenti.</li> </ul> <p>Këto të dhëna mbështeten në Rregulloren e programit të doktoratës dhe i paraqiten Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës “Doktor”, duke siguruar një pasqyrë të qartë dhe të dokumentuar të progresit të doktorantëve dhe cilësisë së programit.</p> <p>Aneksi Nr.87-Puna kërkimore vjetore brezi i parë Aneksi Nr.88-Puna kërkimore vjetore brezi i dytë Aneksi Nr.89-Raportimet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UMT garanton administrim të plotë, të dokumentuar dhe transparent të të gjitha fazave të studimeve doktorale, duke përfshirë aplikimin, përzgjedhjen, ndjekjen akademike dhe raportimin periodik. Dokumentacioni mbahet në formë elektronike dhe fizike, ndërsa mekanizmat si sistemi antiplagjiaturë dhe raportet vjetore sigurojnë cilësi dhe integritet shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>
-----------------------------------------------------------------	--------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	----------------------------------------------

### III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT

#### Standardi III.1

Adresa: Rruga Skënderbeg, Blloku i Ambasadave, Tiranë 1001

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




**Strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e programit të doktoratës kanë të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë në aktet rregullatore dhe harmonizojnë veprimtaritë e tyre në funksion të programit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e programit të doktoratës garanton plotësimin e standardeve akademike dhe ofron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e projektit kërkimor shkencor.</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UMT ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programi i studimit të Ciklit të Tretë Doktoraturë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sisteme Inteligjente”</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i i Shkencave Kompjuterike dhe IT, i cili ka tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;</li> <li>• Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike;</li> <li>• Qendra Kërkimore Shkencore.</li> </ul> <p>Burimet njerëzore: Stafit akademik bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Inxhinierisë Informatike.</p> <p>Nga të dhënat që jepen në DVV, rezulton numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të Inxhinierisë Informatike.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (21 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (Të dhëna të përpunara nga gjetjet e ASCAL):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof. Dr,</li> <li>• 3 Prof. Assoc,</li> <li>• 8 Dr/PhD</li> <li>• 9 Msc</li> </ul> <p>Në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike, i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka 7 pedagogë PAE dhe 10 pedagogë PAK (Ref DVV, ), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="678 1265 1311 1547"> <thead> <tr> <th>Grada, viti akademik 2024-2025</th> <th>Nr. ( ref DVV)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar në CV e stafit akademik rezulton se ai ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë.</p> <p>Burimet Infrastrukturore: Auditore, Klasa për leksione dhe seminare, Laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve. Zyra për stafin. Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, etj</p>	Grada, viti akademik 2024-2025	Nr. ( ref DVV)	Prof. Dr	1	Prof. Asoc.	1	Dr/PhD	4	Msc	1	Total	7
Grada, viti akademik 2024-2025	Nr. ( ref DVV)												
Prof. Dr	1												
Prof. Asoc.	1												
Dr/PhD	4												
Msc	1												
Total	7												
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse bashkërendon në funksion të</p>	<p>Njësia përgjegjëse DIK, demonstron një angazhim të dukshëm dhe të qëndrueshëm në bashkërendimin e veprimtarive akademike,</p>												

<p>realizimit të projektit kërkimor shkencor, veprimtaritë akademike, kërkimore-shkencore dhe krijuese të doktorantëve.</p>	<p>kërkimore-shkencore dhe krijuese të doktorantëve, duke synuar realizimin cilësor të projektit kërkimor shkencor. Ky bashkërendim mbështetet në një kuadër të qartë institucional dhe ligjor, rregulloret e brendshme dhe strategjia afatgjatë e zhvillimit të UM-së, të cilat përqendrohen në forcimin e kërkimit shkencor dhe në integrimin e tij me mësimdhënien dhe zhvillimin profesional të doktorantëve.</p> <p>Verehet qarte që njësia kryesore FSHKIT ka ndërmarrë hapa konkretë për të siguruar një mjedis kërkimor dinamik, përmes partneriteteve me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshjet ndërinstucionale dhe ndërkombëtare (23, siç evidentohen në anekset përkatëse) krijojnë mundësi të gjera për bashkëpunim shkencor, shkëmbime akademike dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. Këto marrëveshje përfshijnë universitete prestigjioze evropiane si France, Italy, Lituani, Rumani etj. dhe kontribuojnë ndjeshëm në ndërkombëtarizimin e kërkimit, një prioritet i qartë i institucionit vitet e fundit.</p> <p>Si rrjedhojë, është e evidente se përmbushja e këtij kriteri është realizuar me efikasitet, duke garantuar një integrim të suksesshëm të doktorantëve në jetën akademike dhe kërkimore dhe duke ndihmuar në zhvillimin e tyre si kërkues të pavarur dhe kontribuues të rëndësishëm në fushat përkatëse.</p> <p>Aneksi Nr. 70 - Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse, nëse përmbush detyrimet ligjore dhe standardet e cilësisë, mund të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor në fushën e kërkimit që mbulon.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike DIK dhe Fakulteti FSHKIT përmbushin detyrimet ligjore sipas ligjit të arsimit të lartë në fuqi. DIK ka 7 personel akademik me kohe të plotë nga të cilët 6 janë me grada shkencore dhe tituj akademik. Verehet një pjesmarje e DIK në disa projekte kërkimore që mbulojnë fusha të avancuara si Inteligenca Artificiale, automatizimi dhe sistemet inteligjente, me aplikime në energjetikë, ambient, mjekësi dhe ekonomi.</p> <p>Këto projekte shtrihen në dy nivele: 1) si pjesë e strategjive kërkimore të departamentit, dhe 2) si pjesë e punës individuale të doktorantëve. Kjo qasje shumëplanëshe ndihmon në ndërlidhjen e objektivave të përgjithshme të institucionit me zhvillimin individual të kërkuesve të rinj shkencorë.</p> <p>Një tjetër tregues i qartë vërehet edhe angazhimi i suksesshëm i institucionit(UMT) në projekte ndërkombëtare të financuara nga programet e Bashkimit Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare si GIZ, BERZH, apo ambasadat e huaja në Shqipëri. Projekte të tilla si MARDS, SMART4ALL, METRIC, DiVA 2024 dhe nisma të tjera inovative e konsolidojnë më tej pozitën e universitetit në kërkimin shkencor.</p> <p>Aneksi Nr. 38 - Lista e projekteve Aneksi Nr. 72 – Lista e projekteve të fituara</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive</p>	<p>DIK, si njësi bazë përgjegjëse, ka marrë rolin koordinues për ofrimin e programit të studimeve të doktoratës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Në rastet kur</p>




<p>bazë, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në marrëveshje ndërmjet tyre dhe më pas ato koordinojnë veprimtaritë në funksion të programit.</p>	<p>fushat e kërkimit përfshijnë ndërthurje ndërdisiplinore me njësi të tjera brenda universitetit, është e parashikuar mundësia që njësia përgjegjëse të mbështetet në mënyrë institucionale nga të gjitha strukturat e tjera të UMT-së. Rregullorja përkatëse e programit të studimit (neni 4.4 dhe 6.2) përcakton qartë mekanizmin e bashkëpunimit ndërmjet njësive dhe ndarjen e përgjegjësisë, duke garantuar një qasje të strukturuar dhe efikase ndaj kërkimit ndërdisiplinor. Kjo qasje përforcon fleksibilitetin dhe funksionalitetin e programit të doktoratës, si dhe rrit cilësinë e mbështetjes akademike për kandidatët.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>DIK demonstroi një angazhim të strukturuar dhe cilësor në organizimin dhe zhvillimin e programit të doktoratës. Bashkërendimi i veprimtarive kërkimore, përfshirja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe funksionimi i qartë institucional në rastet e bashkëpunimit ndërdisiplinor, dëshmojnë për një qasje të qëndrueshme dhe efektive ndaj kërkimit shkencor dhe formimit të doktorantëve.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="577 788 753 869">Përmbushet plotësisht</td> <td data-bbox="759 788 951 869">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="957 788 1149 869">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1155 788 1404 869">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td align="center">X</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi III.2</b> Njësia përgjegjëse garanton personelin e nevojshëm akademik, administrativ dhe mbështetës për zhvillimin e programit dhe realizimin e objektivave të tij.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik i angazhuar në programin e doktoratës është i kategorisë “Profesor” me eksperiencë të gjatë në fushën e kërkimit brenda vendit dhe në universitete partnere të njohura në botë. Ata kanë veprimtari të pasur kërkimore, botuese dhe renditen lart në fushën përkatëse të studimeve në databazat e indeksuara në nivel ndërkombëtar.</p>	<p>Personeli akademik i përfshirë në udhëheqjen e temave të doktoratave përfaqëson një trupë të kualifikuar profesorësh me eksperiencë të gjerë kërkimore, me prani aktive në databaza ndërkombëtare të indeksuara si Scopus dhe Web of Science, duke ofruar një nivel të lartë ekspertize për doktorantët. Megjithatë ka patur largime të dy udhëheqësve, institucioni konform rregullores së programit të studimit dhe legjislacionit të fuqi i ka zëvendësuar me profesorë të fushës duke mos cenuar vazhdueshmërinë dhe kontrollin e punimit të doktoratës.</p> <p>Nëpërmjet zyrës së Burimeve Njerëzore dhe strukturave përkatëse, institucioni administron në mënyrë të rregullt dhe transparente të dhënat e stafit akademik dhe ndjek shpërndarjen e temave të doktoratës bazuar në profilin shkencor të udhëheqësve. Kjo qasje siguron jo vetëm cilësi të lartë në përmbajtjen dhe mbikëqyrjen e punës kërkimore, por edhe një mjedis të mbështetur dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete shkencore.</p> <p>Aneksi Nr. 79 - CV të Udhëheqësve shkencor Aneksi Nr. 80-Dorëheqje personale e udhëheqësit Aneksi Nr. 81-CV të udhëheqësve zëvendësues</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Udhëheqësi/it me titull akademik “Profesor” mund të</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit vërehte se UMT respekton në mënyrë rigorozë kërkesat ligjore dhe standardet cilësore</p>

<p>drejtojë jo më shumë se 3 doktorantë njëkohësisht dhe ata me titull akademik “Profesor i asociuar” jo më shumë se 2, brenda dhe jashtë institucionit.</p>	<p>në drejtimin e doktoratëve, duke garantuar një raport të balancuar mes udhëheqësve dhe studentëve. Udhëheqësit me titullin akademik “Profesor doktor” drejtojnë deri në 3 doktorantë, ndërsa ata me titull “Profesor i asociuar” deri në 2, duke siguruar kohën dhe përkushtimin e duhur për secilin kandidat. Kjo qasje ndihmon në ruajtjen e cilësisë së mbikëqyrjes akademike dhe përmbushjen e objektivave kërkimore të studentëve të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 42-Numri i kuotave të doktorantëve i certifikuar nga Ministria</p> <p>Aneksi Nr. 92-VBA dhe VSA për zëvendësimin e udhëheqësit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret për përzgjedhjen e udhëheqësit, përcaktohet në rregulloren e programit të studimit dhe në akte të tjera të njësisë përgjegjëse. Në këto akte përcaktohen edhe modalitetet e ndryshimit apo zëvendësimit të udhëheqësit në rastet kur është e nevojshme dhe e argumentuar.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se udhëheqësi mund të udhëheqë 2 ose 3 doktorantë konform kërkesave ligjore në fuqi. Ky kriter është respektuar me rigorozitet nga ana e institucionit. Përgjate viteve të shkuara ka patur raste të ndërprerjes së udhëheqësit për arsye personale të udhëheqësit. Nga ana e institucionit është bërë zëvendësimi i udhëheqësit me profesor të fushës apo të fushave të përafërta, kjo mbetet të konfirmohet nga ana e ministrisë dhe QSHA-së. Rregullorja e programit të doktoratës nuk parashikon këtë rast të ndërprerjes së udhëheqësit nga ana e udhëheqësit. Është e nevojshme që këto raste të parashikohen në rregullore, kjo do të jepte garanci për doktorantët dhe vijimësi me korrekte të punës kërkimore-shkencore në kuadër të projektit doctoral.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse garanton se çdo udhëheqës ka kapacitetin për të kryer udhëheqjen e studentit të doktoratës në aktivitetet e kërkimit dhe detyrat respektive didaktike.</p>	<p>Bazuar në DVV, çdo udhëheqës i përfshirë në programin e doktoratës zotëron kapacitetet e nevojshme akademike dhe kërkimore për të mbështetur me cilësi të lartë studentët e doktoratës. Nëpërmjet vlerësimit të CV-ve, monitorimit të vazhdueshëm të performancës dhe anketimit të studentëve, DIK vlerëson që udhëheqësit janë të përditësuar me zhvillimet më të fundit shkencore dhe aplikojnë metoda bashkëkohore në udhëheqjen e kërkimeve. Kjo qasje ka krijuar një ambient akademik dhe kërkimor që nxit zhvillimin profesional të doktorantëve dhe garanton arritjen e rezultateve me standarde të larta shkencore.</p> <p>Aneksi Nr. 79 - Cv të Udhëheqësve shkencor</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik i angazhuar në programin e doktoratës është pjesë aktive e veprimtarive në fushën kërkimore, projekte, referime, botime shkencore, revista, libra a monografi etj dhe përfshin në to studentin në udhëheqje.</p>	<p>Bazuar në DVV rezultojnë se personeli akademik i angazhuar në programin e doktoratës ka një pjesëmarrje aktive dhe të vazhdueshme në veprimtari kërkimore, projekte, botime dhe konferenca shkencore, duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe doktorantët në këto procese. Kjo përfshirje e hershme dhe sistematike e studentëve në aktivitetet shkencore ka nxitur zhvillimin e tyre profesional dhe kërkimor, duke i përgatitur për të kontribuar në komunitetin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar. Kriteret e qarta që duhet të plotësojë studenti para mbrojtjes së doktoratës, përfshirë botimet në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, tregojnë një angazhim serioz të institucionit për të ruajtur standarde të larta akademike dhe kërkimore.</p>




	Aneksi Nr. 79 - Cv të Udhëheqësve shkencor Aneksi Nr. 81 – CV të udhëheqësve zëvendësues Aneksi Nr. 85-Veprimtaritë formuese dhe kërkimore			
<b>Konkluzione</b>	<i>Vërehet se DIK ka anagazhuar udhëheqës të kualifikuar dhe me përvorje në kërkimin shkencor, duke respektuar normat ligjore dhe standardet e cilësisë. Rregullorja e programit doktorat duhet të parashikoj edhe rastet e dorëheqjes dhe zëvendësimit të udhëheqësit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Udhëheqësi ka përgjegjësi për ecurinë e studimeve, punës kërkimore dhe e mbështet atë në mënyrë të vazhdueshme për arritjen e objektivave.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Udhëheqësi është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit.	Bazuar në rregulloren e doktoratës, programi i doktoratës siguron një drejtim të qartë dhe të strukturuar të punës kërkimore përmes një ndarjeje të mirëpërcaktuar të përgjegjësive të udhëheqësit shkencor dhe doktorantit. Përdorimi i metodave të ndryshme në këshillim dhe vlerësim, si dhe përfshirja e stafit akademik mbështetës ndërkombëtarë për secilin doktorant, garanton një mbështetje të vazhdueshme dhe një qasje bashkëkohore në drejtimin e studentëve drejt arritjes së objektivave kërkimore. Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 30 - Propozim+vendim temash dhe udhëheqësish
<b>Kriteri 2.</b> Udhëheqësi shkencor është garantuesi për realizimin e projektit kërkimor shkencor të studentit doktorant duke ofruar eksperiencën e vet, udhëzimet e duhura dhe mbështetjen e vazhdueshme të tij në përmbushje të qëllimit dhe objektivave.	Bazuar në rregullore e programit doktorat dhe konstatimi pergjate vizitës në institucione rezulton se udhëheqësi shkencor luan një rol të rëndësishëm në procesin e doktoratës, duke qenë garantuesi kryesor për realizimin me sukses të projektit kërkimor të studentit. Ai ofron një mbështetje të gjithanshme dhe të vazhdueshme për doktorantin, duke përfshirë udhëzime për strukturimin e punimit, zgjedhjen e metodologjisë së përshtatshme, orientimin drejt literaturës bashkëkohore, si dhe respektimin e normave shkencore dhe etike të kërkimit. Për më tepër, ai siguron një ambient që nxit zhvillimin profesional dhe akademik të doktorantit, duke e ndihmuar atë të përmbushë objektivat kërkimore të përcaktuara. Përgjegjësitë e udhëheqësit përfshijnë edhe ndërhyrjen në kohë kur puna kërkimore devijon nga standardet e kërkuara, si dhe inkurajimin e përfshirjes së doktorantit në aktivitete shkencore si konferenca, botime dhe projekte bashkëpunuese. Në rastet e përfshirjes së bashkëudhëheqësve, veçanërisht në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, udhëheqësi ruan kontakt të rregullt dhe dokumenton bashkëpunimin për të garantuar një vazhdimësi efektive të mbështetjes akademike. Kjo qasje siguron jo vetëm cilësinë e kërkimit shkencor,

	<p>por edhe përgatitjen e doktorantëve për sfidat e kërkimit dhe inovacionit në një kontekst ndërkombëtar.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit</p> <p>Aneksi Nr.53-Vlerësime, komente, komunikime udhëheqës-doktorant</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Udhëheqësi shkencor punon për përditësimin e njohurive dhe aftësive didaktike të studentit në fushën e studimit dhe e përfshin atë në veprimtari akademike të mësimdhënies në ciklin e parë dhe të dytë në programet që institucioni ofron.</p>	<p>Udhëheqësit shkencor të doktoratave dhe doktorantët janë në përgjithësi staf akademik i njësisë bazë DIK ose staf i fakultetit FSHKIT. Edhe profesorët udhëheqës zëvendësues kane një jete akademike të pasur nderkombetare dhe evidente të mbështetur në projekte shkencore kombetare dhe nderkombetare. Të gjithë doktorantët janë të angazhuar në mësimdhënie dhe janë të angazhuar në projekte shkencore dhe kerkimore. Gjithashtu është e dukshme edhe pjesëmarrja e doktorantëve në mobilitete të ndryshme në kuadër të projekte të ndryshme si dhe pjesëmarrja e tyre në artikuj shkencor me profesor dhe pedagog të universiteteve pritës.</p> <p>Aneksi Nr. 70 - Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus</p> <p>Aneksi Nr. 71 - Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe udhëheqësi e programit të doktoratës përzgjidhen nga njësi përgjegjëse pas konsultimit me Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". Miratimi i udhëheqësit shkencor bazohet në përputhshmërinë e fushës së studimeve të tij, arritjeve dhe projektit të doktorantit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes se vetëvlerësimit rezulton se procesi i përzgjedhjes së udhëheqësve shkencorë dhe personelit akademik në programin e doktoratës është i ndërtuar mbi parime transparence, kompetence dhe përputhshmërie shkencore. Përzgjedhja realizohet nga DIK dhe Dekanati dhe miratohet nga Senati Akademik, pas konsultimit me Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës "Doktor". Kjo strukturë vendimmarrjeje siguron që çdo udhëheqës shkencor të jetë i kualifikuar, me përvojë dhe ekspertizë në fushën përkatëse të kërkimit të doktorantit.</p> <p>Miratimi i udhëheqësit nuk bazohet vetëm në kualifikimet e tij akademike, por edhe në përputhshmërinë me projektin kërkimor të doktorantit dhe në aftësinë për të mbështetur progresin dhe suksesin e tij gjatë gjithë periudhës së studimeve. Kjo qasje e strukturuar dhe meritokratike ka kontribuar në sigurimin e cilësisë së lartë të kërkimeve shkencore, në një udhëheqje efektive dhe në krijimin e një ambienti që nxit zhvillimin profesional dhe akademik të studentëve të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit</p> <p>Aneksi Nr. 34-Komisionet ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur programi i studimeve të doktoratës ofrohet nga më shumë se një institucion) siguron/jnë që studentët e doktoratës të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre për arritjen e suksesit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se UMT ka vendosur bashkëpunime të strukturuar me universitete si Université Grenoble Alpes (Francë), University of Craiova (Rumani) dhe University of Tennessee at Chattanooga (SHBA), duke ofruar kështu një qasje ndërkombëtare dhe multidisiplinare në procesin e drejtimit të doktoratës.</p> <p>Ky bashkëpunim ndër-institucional siguron që studentët të përfitojnë nga ekspertiza e shumëanshme e mentorëve, nga burime të avancuara akademike dhe kërkimore, si dhe nga një komunikim i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve. Krijohet një mjedis stimulues dhe i mbështetur ku doktorantët marrin udhëzime të qarta dhe të personalizuara në çdo fazë të punës së tyre shkencore. Kjo qasje</p>

	<p>gjithëpërfshirëse ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm akademik, në rritjen e cilësisë së kërkimit dhe në rritjen e potencialit për sukses profesional dhe shkencor të doktorantëve.</p> <p>Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse siguron që udhëheqësi ka kohën e mjaftueshme dhe jep mbështetjen e nevojshme për studentin e doktoratës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të dosjes DVV dhe biseda me udhëheqësit doktoral rezukton se stafi udhëheqës është i parashikuar të këtë një norme ngarkese mësimdhënie objektive. Në përgjithësi stafi udhëheqës aktual ishte në pozita drejtuese kryesisht dhe kishte një norme mesimore të reduktuar si dhe mbështetja nga ana e institucionit. Mbështetja e ofruar nuk është vetëm formale, por e integruar në politikën institucionale të menaxhimit të ngarkesës vjetore të punës, ku puna me doktorantët njihet si një pjesë e rëndësishme e kontributit akademik të stafit, me një normë të përcaktuar prej 100 orësh në vit. Kjo strukturë i lejon udhëheqësit të fokusohen në cilësinë e drejtimit shkencor, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin profesional të studentëve dhe në realizimin me sukses të projekteve të tyre kërkimore.</p> <p>Aneksi Nr. 69 - Draft kontratë individuale pune, pedagog i jashtëm Aneksi Nr. 94 - Model, kontratë pune e udhëheqësve</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në bashkëpunim me studentin, njësia përgjegjëse garanton vijimësi në udhëheqjen e tij në rastet e zëvendësimit të udhëheqësit për shkaqe të ndryshme.</p>	<p>Përgjatë dy viteve akademike 2022-23 dhe 2023-24 ka patur dy largime të udhëheqësve të cilët janë zëvendësuar nga ana e institucionit me udhëheqës të rinj shkencor. Nuk parashikohet këto raste në rregulloren e programit doktoral megjithëse institucioni ka vepruar shpejt në zëvendësimin e tyre. Megjithatë duhen parashikuar këto raste dhe institucioni duhet të sigurojë vazhdimësinë e udhëheqjes së doktorateve pavarësisht se ka edhe profesor mbështetës të huaj.</p> <p>Aneksi Nr. 81 - CV të udhëheqësve zëvendësues Aneksi Nr. 80-Dorëheqje personale e udhëheqësit</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Takimet ndërmjet udhëheqësit dhe doktorantit janë zyrtare e të dokumentuara dhe shërbejnë për vlerësimin e raporteve të progresit të doktorantit.</p>	<p>Takimet ndërmjet udhëheqësit shkencor dhe doktorantit janë zhvilluar në mënyrë të strukturuar, zyrtare dhe të dokumentuar, duke përbërë një element të domosdoshëm për vlerësimin sistematik të progresit kërkimor. Këto takime planifikohen dhe realizohen rregullisht, me synimin për të monitoruar ecurinë e projektit, për të dhënë feedback të vazhdueshëm dhe për të adresuar në kohë çdo problematikë që mund të paraqitet gjatë zhvillimit të doktoratës.</p> <p>Përveç takimeve zyrtare, komunikimi i hapur dhe informal ndërmjet udhëheqësit dhe doktorantit mbështet një proces dinamik bashkëpunimi, duke nxitur shkëmbimin e ideve dhe zgjidhjen efektive të çështjeve të përditshme kërkimore. Kjo qasje e dyfishtë – formale dhe informale – kontribuon në krijimin e një marrëdhënieje konstruktive dhe bashkëpunuese, e cila mbështet avancimin shkencor të doktorantit dhe ndihmon në arritjen e objektivave të programit. Dokumentimi i rregullt i takimeve shërben gjithashtu si provë për progresin dhe angazhimin reciprok, duke garantuar transparencë dhe cilësi në procesin e drejtimit të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 53 - Vlerësime, komente, komunikime udhëheqës-doktorant</p>

<p><b>Kriteri 9.</b> Udhëheqësi shkencor jep konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, për realizimin e projektit kërkimor shkencor të doktoratës dhe në bazë të ecurisë, miraton planin e veprimtarive në vijim.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezultojnë se udhëheqësi ndjek në mënyrë sistematike progresin e studentit dhe, në bazë të rezultateve të arritura, formulon konkluzione të qarta që orientojnë veprimtaritë e ardhshme kërkimore. Ky proces siguron që puna e doktorantit të jetë në linjë me objektivat e përcaktuara dhe që çdo fazë e projektit të marrë drejtimin dhe mbështetjen e duhur. Për më tepër edhe rregullorja e programit parashikon përfshirjen e një oponenti të jashtëm, i cili jep një raport vjetor të pavarur mbi ecurinë e doktoratës. Ky vlerësim i jashtëm, i kombinuar me raportet e përgatitura nga udhëheqësi shkencor, krijon një kuadër të balancuar dhe transparent vlerësimi, duke mundësuar identifikimin e sfidave, rregullimin e planit të punës dhe përmirësimin e marrëdhënies akademike. Kjo strukturë garanton cilësinë e lartë të kërkimit dhe siguron që procesi i doktoratës të jetë i mbikëqyrur, i dokumentuar dhe në përputhje me standardet shkencore dhe institucionale.</p> <p>Aneksi Nr. 53 - Vlerësime, komente, komunikime udhëheqës-doktorant Aneksi Nr. 54 - Model vlerësimi i Oponentit të jashtëm Aneksi Nr. 58 - Vlerësimi i Oponentëve të jashtëm</p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Udhëheqësi shkencor garanton plotësimin e të gjitha vërejtjeve dhe rekomandimet e jurisë kur disertacioni rikthehet për plotësim.</p>	<p>Udhëheqësi shkencor ka një rol qendror në fazën përfundimtare të doktoratës, veçanërisht kur disertacioni rikthehet për plotësim nga juria. Ai garanton që të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e dhëna nga juria të trajtohen në mënyrë të plotë dhe rigorozë, duke udhëzuar doktorantin për të realizuar përmirësimet e nevojshme. Ky proces përfshin analizimin e çdo komenti të jurisë dhe integrimin e tyre në disertacion, me qëllim që punimi të përmbushë plotësisht standardet akademike dhe shkencore të kërkuara për miratim.</p> <p>Kjo përgjegjësi e udhëheqësit nuk kufizohet vetëm në aspektin teknik të korrigjimeve, por përfshin gjithashtu mbështetjen në rritjen cilësore të përmbajtjes së kërkimit dhe në përgatitjen e doktorantit për mbrojtjen përfundimtare.</p> <p>Aneksi Nr. 10 - Rregullore e programit të studimit</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Udhëheqësit shkencor aktual luajnë një rol thelbësor dhe shumë dimensional në garantimin e cilësisë së procesit të doktoratës, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme akademike, metodologjike dhe profesionale për studentin. Përmes një strukture të qartë përgjegjësisë, komunikimi të dokumentuar, vlerësimeve të rregullta dhe bashkëpunimit institucional, sigurojnë një mjedis kërkimor i qëndrueshëm dhe efektiv.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmirësimi i Përmirësimi</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi III.4</b> Njësia përgjegjëse garanton infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme në funksion të programit të doktoratës.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse e programit të doktoratës ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se UMT siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse si dhe ato të programit të doktoratës. Aktiviteti didakti shtrihet në tre godina në Qytetin Studenti, Tiranë, Rruga “Budi” dhe “Sotir Kolea” me sipërfaqe totale përkatësisht 2347m<sup>2</sup>, 2490 m<sup>2</sup> dhe 740m<sup>2</sup>.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti në ambientet e tij, vlerësoi se ato kanë kushte të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve didaktike të parashikuara. Megjithatë, GVJ nuk ka të dhëna të plota në lidhje me shfrytëzimin e këtyre ambienteve edhe nga programet e tjera të studimit të ofruara nga institucioni. Besojmë se ky kriter vlerësohet në tërësi gjatë akreditimit institucional dhe jo atij të një programi studimi. Edhe gjatë takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u vu në dukje që ambientet e institucionit janë të bollshme për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni dhe ky parametër në tërësi është vlerësuar gjatë akreditimit institucional.</p> <p>Aneksi Nr. 64 - Kapacitetet infrastrukturore Shënimet e vizitave në UMT;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Studentët e pranuar në programin e studimit, kanë kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e kërkimor shkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Në sallat laboratorike tek të cilat zhvillohet aktiviteti laboratorik me ndihmën e kompjuterëve, ishin të instaluar softëare profesionale, projektor etj. të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Aneksi Nr. 64 - Kapacitetet infrastrukturore Shënimet e vizitave në UMT;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i doktoratës ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm, vizitoi ambientet e UMT dhe në veçanti ambientet e bibliotekës. Gjatë kësaj vizite, por edhe nga takimi me studentët dhe stafin akademik, u vu re se biblioteka mund të përdoret nga të gjithë studentët dhe stafi akademik në mënyrë të barabartë pa pagesë. Në bibliotekë gjendeshin edhe disa PC që lejonin aksesin e literaturës në format elektronik. Përveç materialeve fizike, biblioteka ofron akses në një sërë platformash ndërkombëtare të hapura dhe me përmbajtje të gjerë shkencore, duke përfshirë databaza si SpringerOpen, JSTOR, CORE, ArXiv, MDPI, DOAJ, ResearchGate, etj. Studentët doktorantë dhe stafi akademik kanë mundësi të shfrytëzojnë këto burime falas, si në ambientet e bibliotekës ashtu edhe online.</p> <p>Megjithatë, mendojmë se biblioteka nuk ka hapësirën e mjaftueshme në funksion të të gjithë programeve të studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Aneksi Nr. 44 – Lista e bibliotekave online</p>

	Aneksi Nr. 64 - Kapacitetet infrastrukturore
<b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse garanton mbështetjen logjistike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe veprimtarive publike dhe botuese.	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (DIK) ndjek dhe mbështet zhvillimin profesional të personelit akademik, duke i orientuar jo vetëm drejt kërkimit të pavarur shkencor, por edhe drejt përfshirjes aktive në projektet kërkimore të fituara nga institucioni. Këto projekte, të menaxhuara nga Zyra e Marrëdhënive me Jashtë dhe Projektet, u ofrojnë stafit mundësi për botime shkencore dhe, në disa raste, edhe mbështetje financiare. Punimet kërkimore të personelit janë botuar në revistën shkencore të UMT, "Journal of Business and Economics" (e pajisur me Bord Shkencor dhe e indeksuar në Copernicus), si dhe në revista të njohura ndërkombëtare me faktor impakti. Aneksi Nr. 23 - Mbështetja financiare për doktoratën Aneksi Nr. 86-Publikimet shkencore
<b>Kriteri 5.</b> Në fushat ku është e nevojshme kryerja e punës së doktoratës në laboratorë kërkimorë, njësia përgjegjëse garanton laboratorë të certifikuar ose bashkëpunon me institucione të tjera partnere jashtë institucionit për realizimin e punës kërkimore shkencore.	GVJ konstaton se UMT disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/semnareve janë të pajisuara me PC, projektore. Biblioteka dhe laboratorët e informatikës janë të pajisura PC me programet e nevojshme. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët mund të shfrytëzohen lehtësisht nga stafi përkatës akademik. Por duhet theksuar se UMT nuk ka ndonjë laborator të certifikuar dhe kapacitetet përpunuese të laboratorëve nuk janë brenda kërkesave minimale të kërkuara në këtë fushë kërkimore. UMT duhet të bëjë përpjekje për të ndërtuar laboratorë të mirefilltë shkencor për të garantuar rezultate të sigurta dhe të besueshme. Aneksi Nr. 64 - Kapacitetet infrastrukturore Aneksi Nr. 66 - Lista e Laboratoreve në përdorim të programeve
<b>Kriteri 6.</b> Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme në institucion ose në institucionin partner për një periudhë së paku 6 muajore.	Nga shqyrtimi dosjes dhe nga konstatimi përgjatë vizitës në institucion vërehet se kryesisht kërkimet shkencore dhe hulumtimet janë kryer në bashkëpunim me universitet partnere. Doktorantët të cilët janë edhe staf akademik efektiv kanë kryer mobilitete disa muajore pranë këtyre universiteteve, kohe në cilët kanë kryer edhe eksperimentet laboratorike të cilët i kanë ndihmuar në publikimet përkatëse. Aneksi Nr. 71-Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT
<b>Kriteri 7.</b> Njësia përgjegjëse ve në dispozicion të programit doktoral sistemin elektronik të administrimit të informacionit për të mirëmenaxhuar raportimet, komunikimet, raportet e vlerësimit të ecurisë dhe të progresit të doktorantit.	Gjatë vizitës në institucion u evidentua se DIK, ka vënë në funksion një sistem të avancuar elektronik për administrimin e informacionit, Edu4School, i cili mbështet dhe lehtëson menaxhimin e plotë të procesit të doktoraturës. Ky sistem shërben për të administruar në mënyrë efikase raportimet periodike, komunikimet ndërmjet doktorantëve dhe udhëheqësve shkencorë, si dhe raportet e vlerësimit të ecurisë dhe progresit të doktorantëve. Përdorimi i këtij sistemi garanton transparencë, strukturë të qartë dhe ndihmon në ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit të nevojshëm në çdo fazë të studimeve të doktoratës. Shënime të vizitës në UMT.
<b>Kriteri 8.</b> Njësia përgjegjëse siguron kapacitetet e mjaftueshme	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (DIK) garanton kapacitetet e nevojshme për të udhëhequr dhe mbështetur doktorantët deri në




për të udhëhequr doktorantët deri në fund të programit dhe të monitorojë progresin e doktorantit duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me udhëheqësin, si dhe të sigurojë raportimet e rregullta gjatë gjithë periudhës.	përfundimin e suksesshëm të programit të tyre. Përmes një mekanizmi të strukturuar mbikëqyrjeje, DIK mban kontakte të rregullta dhe të dokumentuara ndërmjet doktorantit dhe udhëheqësit shkencor, duke mundësuar ndjekjen e vazhdueshme të progresit dhe zhvillimeve kërkimore. Raportimet periodike, si pjesë e kësaj strukture monitoruese, sigurojnë transparencë dhe angazhim të ndërsjellë, duke krijuar një ambient mbështetës dhe të qëndrueshëm për zhvillimin akademik të doktorantëve Aneksi Nr. 53 - Vlerësime, komente, komunikime udhëheqës-doktorant		
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike siguron mbështetje të plotë për zhvillimin e programit të doktoratës përmes infrastrukturës akademike, bibliotekës, sistemit elektronik të administrimit dhe angazhimit të vazhdueshëm të udhëheqësve shkencorë. Komunikimi, monitorimi dhe vlerësimi i progresit të doktorantëve janë të strukturuar dhe të dokumentuara rregullisht. Megjithatë, evidentohet si mangësi mungesa e një laboratorit të certifikuar kërkimor, i cili do të forconte më tej kapacitetet praktike dhe shkencore të programit. Rekomandohet ngritja e një laboratorit të mirëfillt kërkimor në fushën e inteligjencës artificiale, të pajisur me infrastrukturë moderne dhe burime teknike të mjaftueshme për të mbështetur kërkimin shkencor eksperimental dhe programet e avancuara të studimit, përfshirë doktoraturën.</i>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
		X	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni siguron partneritet dhe bashkëpunim me institucione të cilat mbështesin veprimtarinë kërkimore shkencore të studentit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse siguron marrëveshje me institucione të arsimit të lartë, institute kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që mbështesin shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës, si dhe veprimtaritë të tjera akademike e kërkimore.	Bazuar në DVV, rezulton se UMT ka ndërtuar një rrjet të qëndrueshëm bashkëpunimi me universitete dhe institute kërkimore brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar shkëmbimin e stafit dhe studentëve të doktoratës. Këto marrëveshje të dokumentuara kanë mbështetur veprimtaritë akademike dhe kërkimore dhe kanë përforcuar angazhimin e institucionit për ndërkombëtarizim dhe cilësi në kërkimin shkencor. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë ftuar edhe profesor të huaj për të kryer leksione të hapura se bashku me studentët e doktoratës. Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës Aneksi Nr. 59 - Leksione të hapura në kuadër të doktoratës Aneksi Nr. 70 - Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+ Aneksi Nr. 71 - Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse siguron përfshirjen në programin e doktoratës të personelit akademik	Bazuar në kontratat në dosjen e vetëvlerësimit rezulton se FSHKIT ssi njësi kryesore e UMT-se ka siguruar bashkëpunime të rëndësishme ndërkombëtare me universitete prestigjioze në vendet anëtare të BE-

Adresa: Rruga Skënderbeg, Blloku i Ambasadave, Tiranë 1001

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

37

<p>si udhëheqës shkencor, lektor ose si bashkëpunëtorë shkencorë të doktorantëve të paktën të një universiteti në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës.</p>	<p>së dhe G20-ës, duke përfshirë ESIEE Paris, Université Grenoble Alpes, Universitetin e Craiova-s dhe University of Tennessee at Chattanooga. Këto marrëveshje kane mbështetur përfshirjen e personelit të huaj si profesor mbështetës dhe bashkëpunëtorë shkencorë në programin e doktoratës. Disa nga doktorantët kane realizuar artikuj shkencor të përbashkët duke shfrytëzuar kapacitet e laboratorëve të universiteteve pritës.</p> <p>Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës Aneksi Nr. 86-Publikimet shkencore Shenime të vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse siguron marrëveshje me të paktën një universitet nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës së paku për një periudhë 3 mujore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe konfirmimi i doktorantëve përgjatë vizitës rezulton se UMT ka kryer disa marrëveshje në kuadër të ndërkombëtarizimit të tij. Aktualisht, ishin në fuqi mbi 23 marrëveshje bashkëpunimi me universitete si Universiteti i Masaryk (Çeki), UPEC (Francë), Universiteti Teknik i Rigës dhe Universiteti i Letonisë (Letoni), Universiteti Politeknik i Barit dhe i Molise (Itali), Universiteti Alexandru Ioan Cuza i lasit dhe Universiteti Politeknik i Timisoarës (Rumani), si dhe një sërë institucionesh të tjera nga Polonia, Spanja dhe Bullgaria. Gjithashtu, studentët e doktoratës kanë përfituar nga mundësitë e mobilitetit, veçanërisht drejt universiteteve franceze falë mbështetjes së Ambasadës Franceze, duke realizuar qëndrime disa mujore të dokumentuara dhe me impakt të qartë në punën kërkimore.</p> <p>Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës Aneksi Nr. 76 - Bursat e fituara në kuadër të doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse siguron marrëveshje me institucione ndërkombëtare që sigurojnë përfshirjen e studentëve doktorantë në projekteve kërkimore të përbashkëta. Për shkencat albanologjike bashkëpunimi mund të jetë edhe me një Institucion të Arsimit të Lartë apo qendër kërkimore në Kosovë dhe në trojet shqiptare.</p>	<p>GVI, bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UMT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me institucione ndërkombëtare. Disa nga doktorantët që janë staf akademik efektiv i FSHKIT kanë marrë pjesë në programe prestigjioze si Erasmus+ KA2, Horizon 2020, COSME, COST Action, CEI, si dhe në thirrje të tjera nga ambasadat e huaja, BERZH, GIZkjo tregon një angazhim të fortë institucional në krijimin e një mjedisi kërkimor të hapur dhe ndërkombëtar. Angazhimi i studentëve të doktoratës në këto projekte është konkret dhe i dokumentuar, ndërsa impakti i tyre është i dukshëm në zhvillimin profesional dhe shkencor të studentëve dhe stafit. Organizimi i konferencave ndërkombëtare si CoNTESA'24, i mbajtur në dhjetor 2024, është një dëshmi shtesë e përfshirjes aktive të FSHKIT në rrjete shkencore ndërkombëtare dhe një platformë për prezantimin e rezultateve të punës kërkimore të studentëve të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 14 - Marrëveshjet në kuadër të doktoratës Aneksi Nr. 72 - Lista e projekteve të fituara</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni krijon mekanizmat e nevojshme për zhvillimin e programeve të</p>	<p>Aktualisht, Universiteti "Metropolitan Tirana" ofron në mënyrë të pavarur programin e doktoratës në fushën e inteligjencës artificiale</p>

përbashkëta të studimeve të doktoratës me universitete homologe në rajon ose në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës.	dhe sistemeve inteligjente. Megjithatë, në këto dy vite të para të funksionimit të programit, institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë për krijimin e mekanizmave që synojnë zhvillimin e programeve të përbashkëta të doktoratës me universitete partnere nga Bashkimi Evropian, OECD apo G20. Gjate takimit me Zyren e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve na u konfirmua se kishin kontakte me 2-3 universitete vetëm për pjesën e programit të doktoratës. Shënime të takimeve. Aneksi Nr. 14 - Marrëveshje në kuadër të doktoratës		
<b>Konkluzione</b>	<i>UMT ka treguar një angazhim të qartë në drejtim të ndërkombëtarizimit të programit të doktoratës përmes marrëveshjeve me universitete dhe institucione kërkimore prestigjioze nga vendet e BE-së, OECD dhe G20, duke përfshirë doktorantë në mobilitete dhe projekte të përbashkëta kërkimore. Edhe pse aktualisht programi ofrohet individualisht, janë vendosur mekanizma të qëndrueshëm për zhvillimin e programeve të përbashkëta doktorature në të ardhmen, duke siguruar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe rritje të cilësisë kërkimore.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>projekti të përbashkëta kërkimore</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni përgjegjës për programin e doktoratës dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe siguron mjetet e duhura të financimit dhe mbështetjes së studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni nëpërmjet raporteve dhe auditevefinanciare dëshmon ecuri pozitive dhe qëndrueshmëri në gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare.	Bazuar në RVB dhe vizitën në Institucion, UMT bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik (janar-dhjetor). Raporti i auditit, i depozituar në QKB, përmban të gjitha detyrimet dhe të ardhurat sipas bilancit të institucionit. Gjithashtu institucioni harton një raport të përgjithshëm dhe jo vetëm financiar i cili depozitohet në institucionet përkatëse (ministria përgjegjëse për arsimin) sipas akteve ligjore në fuqi. Administratori i UMT përgjigjet për realizimin e planit financiar dhe raporton në Bordin e Administrimit për veprimtarinë ekonomike-financiare. GVJ nuk ka në dispozicion një raport të detajuar ekonomik/financiar për këtë program studimi. Megjithatë, mendojmë se bazuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit, UMT garanton nevojat financiare për mbulimin e këtij programi studimi. Aneksi Nr. 73 - VBA, projekt buxheti për kërkim-shkencor RVB; Shënime të vizitave në UMT
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse siguron nëpërmjet institucionit, projekteve ose financimeve nga subjekte të tjera fondet e	Në dispozicion të GVJ nuk është vendosur një raport financiar i detajuar për projektin shkencor apo një plan financimi të tij. Ajo që disponohet është në nivel institucioni ku detajohen shpenzimet të ndara në zërat kryesor. Megjithatë bazuar në dokumentacionin në DVV,

Adresa: Rruga Skënderbeg, Blloku i Ambasadave, Tiranë 1001

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>nevojshme për zhvillimin e projektit të kërkimit shkencor.</p>	<p>UMT siguron burime të qëndrueshme financiare për mbështetjen e projekteve të kërkimit shkencor përmes një kombinimi të granteve kombëtare e ndërkombëtare, kontributeve nga aksioneri, shërbimeve për të tretë dhe të ardhurave nga tarifatat e studimit. Plani i financimit është i strukturuar në mënyrë që të mbulojë nevojat për burime njerëzore, infrastrukturë kërkimore, akses në literaturë dhe shpenzime operacionale, duke u hartuar në bashkëpunim me njësitë bazë për të garantuar realizimin cilësor të programit të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Mbështetja financiare për doktoratën Aneksi Nr. 72 - Lista e projekteve të fituara</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për kërkim.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit DVV, rezulton se nuk ka një buxhet të mirefillte për këtë program studimi. Rezulton që në disa raste UMT ka mbështetur financiarisht pjesëmarrjen e doktorantëve në konferenca, duke mbuluar tarifën e konferencës, udhëtimin dhe akomodimin. GVJ nuk ka në dispozicion një raport të detajuar ekonomik/financiar për këtë program studimi. Megjithatë, mendojmë se bazuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit, UMT garanton nevojat financiare për mbulimin e këtij programi studimi.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Mbështetja financiare për doktoratën Aneksi Nr. 84 - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse siguron të ardhura nga shërbime ndaj subjekteve të tjera në kuadër të zhvillimit të programit të doktoratës dhe i përdor ato në funksion të zhvillimit të programit.</p>	<p>Aktualisht, UMT nuk gjeneron të ardhura të drejtpërdrejta nga ofrimi i shërbimeve ndaj subjekteve të tjera në kuadër të programit të doktoratës. Mungesa e një laboratorit të mirëfillt shkencor në fushën AI dhe sisteme inteligjente ka për të penalizuar realizimin e të ardhurave në kuadër të këtij programi doktoratë.</p> <p>RVB. Shënime të vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të doktoratës përputhet me politikën dhe nevojat e kërkimit shkencor të institucionit.</p>	<p>Megjithëse nuk rezulton të këtë një politike të qartë të shpërndarjes së buxhetit ndërmjet programeve të studimit, UMT synon që ta mbështesë plotësisht dy brezat e studentëve të doktoratës. Buxheti mbulon nevojat thelbësore si financimi i projekteve kërkimore të doktorantëve, mbështetja për stafin akademik, përmirësimi i infrastrukturës, bursa për doktorantët, mobiliteti ndërkombëtar dhe publikimet shkencore.</p> <p>Aneksi Nr. 23 - Mbështetja financiare për doktoratën Aneksi Nr. 73 - VBA, projekt buxheti për kërkim-shkencor</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimet e jashtme të përfituara për kërkim shkencor janë tregues të veprimitarisë kërkimore me nivel të lartë dhe administrohen për mbarëvajtjen e programit përkatës të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit DVV, rezulton se nuk ka financime të jashtme të përfituara në kuadër të projekteve shkencore të programeve të doktoratës. Duhet që institucioni të bëjë përpjekje për bashkëpunime me qëllim përfitimi të kuadër të projekteve të ndryshme që parashikon secili doktorant. Gjate takimit me doktorantët u cilësua ky fakt me qëllim të rritjes edhe të bashkëpunimit me aktor vendas.</p> <p>DVV. Aneksi Nr. 23 - Mbështetja financiare për doktoratën</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Modalitetet e përdorimit të të ardhurave nga projektet dhe shërbimet ndaj subjekteve të tjera rregullohen me akte të posaçme të njësisë kryesore dhe miratohen nga administratori i saj.</p>	<p>Megjithëse nuk ka të ardhura të fituara nga projektet e doktoratës, rezulton se UMT ka fituar disa projekte në nivel institucional. Të ardhurat e këtyre projekteve janë rregulluar me kujdes për t'u siguruar që ato përdoren në mënyrë efektive, në përputhje me objektivat e programit kërkimor dhe standardet akademike. Kjo përfshin planifikimin financiar, monitorimin e progresit të projekteve dhe raportimin e rezultateve, që ndihmon në sigurimin e transparencës dhe efektivitetit të përdorimit të këtyre fondeve.</p> <p>Aneksi Nr. 12 - Reforma e kërkimit shkencor Aneksi Nr. 72 - Lista e projekteve të fituara</p>								
<p><b>Kriteri 8.</b> Përdorimi i mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të doktoratës është objekt i raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në DVV, UMT kryen auditim të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi. Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë në sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të vitit pasardhës).</p> <p>Aneksi Nr. 83 - Raport Auditues UMT Shënime të vizitës në institucion.</p>								
<p><b>Kriteri 9.</b> Kandidatët e pranuar mund të përfitojnë nga financimi i siguruar nga institucioni, të ardhurat dytësore apo të vetëfinancohen për studimet e doktoratës.</p>	<p>Bazuar në DVV, rezulton se UMT parashikon një model fleksibël financimi për studentët e doktoratës, duke u mundësuar atyre vetëfinancim, përfitim nga grante kërkimore ose financim të plotë nga vetë institucioni. Aktualisht, të gjithë doktorantët janë të financuar plotësisht nga UMT, dhe për këtë mbështetje janë lidhur kontrata të posaçme që përcaktojnë detyrimet dhe kontributin e doktorantëve ndaj institucionit pas përfundimit të studimeve doktorale.</p> <p>Aneksi Nr. 45 - Aneksi kontratë shërbimi e doktoranti Aneksi Nr. 27 - Kontratë shërbimi e doktorantit</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i doktoratës siguron mundësi të ndryshme financimi për studentët, përfshirë vetëfinancimin dhe mbështetjen nga institucioni, në përputhje me aktet rregullative përkatëse. Megjithatë, evidentohet mungesa e një laboratorit të certifikuar, çka përbën një mangësi në infrastrukturën kërkimore të nevojshme për një formim të plotë shkencor. Kjo situatë kërkon përmirësim për të garantuar standarde më të larta akademike dhe kërkimore.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="563 1485 986 1601"></td> <td data-bbox="994 1485 1193 1601">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1201 1485 1410 1601">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </table>				Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht							
	X								

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="563 1664 986 1800"></td> <td data-bbox="994 1664 1193 1800">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1201 1664 1410 1800">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>				Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht							
		X							

#### IV. KËRKIMI SHKENCOR, ARRITJET DHE REZULTATET

Adresa: Rruga Skënderbeg, Blloku i Ambasadave, Tiranë 1001  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

41

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Ngritja e vazhdueshme e nivelit teorik dhe nxitja e punës kërkimore janë pjesë e planit të veprimtarive të kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Niveli i zhvillimit të kërkimit shkencor ndihmon në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit.	<p>Programi i studimit i ciklit të tretë, “Doktoratë” i ofruar në UMT, bazohet në aktet rregullatore në fuqi. Doktoratat ngrihen mbi projekte të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, projekte të cilat së bashku me vërtetimin e kapaciteteve akademiko-shkencore, miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimimin.</p> <p>Mbi këto projekte të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, hartohen projektet individuale të kërkimit shkencor për çdo student doktorant. Bazuar në rregulloren e këtij programi studimi, parakusht i pranimit të studentëve është përfundimi me sukses i një cikli studimi të nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), cikël studimesh që është në fushën e shkencave të aplikuara të lidhura ngushtësisht me objektivat e studimeve të doktoratës.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të tretë, doktoratë, në përputhje me nivelin 8 të KSHK, ka në bazë kërkimin shkencor në fushën e kompetencës. Ky kriter vlerësohet edhe në kuadër të analizës së projekt-propozimeve të kërkimit shkencor dhe zhvëllimor të realizuara në UMT në brezin e parë dhe të dytë të këtij program (dy breza që janë aktiv në UMT në momentin e vlerësimit të jashtëm).</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit  Aneksi Nr. 14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës  Aneksi Nr. 21-Model projekt propozimi  Aneksi Nr. 22-Projekt propozim i plotësuar  Aneksi Nr. 24-Model formulari i raportit të progresit për studentët e Doktoratës  Aneksi Nr. 30-Propozim+vendim temash dhe udhëheqësish  Aneksi Nr. 32-Projekt propozimet individuale brezi i parë  Aneksi Nr. 33-Projekt propozimet individuale brezi i dytë</p>
<b>Kriteri 2.</b> Studentët e doktoratës marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara të doktoratës jashtë punës kërkimore të tyre si ligjërata, seminar, debate ndërdisiplinare, të organizuara në kuadër të programit të doktoratës, ndjekin prezantime të doktorantëve dhe të projekteve kërkimore edhe kur kjo nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të studentit.	<p>Studentët e ciklit të tretë, doktoratë në UMT, përtej angazhimit të tyre në kërkimin shkencor në projektin e tyre individual, angazhohen edhe në aktivitete didaktike në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë në UMT, Brenda fushës së tyre të kompetencës.</p> <p>Studentët gjithashtu, marrin pjesë edhe në aktivitetet që kanë në focus përhapjen e njohurive. siç janë leksione të hapura, seminare tematike apo edhe ditë informuese si për studentët potencial në UMT, ashtu edhe për studentët doctorand të viteve pasardhëse.</p> <p>Aneksi Nr. 59-Leksione të hapura. në kuadër të doktoratës  Aneksi Nr. 85-Veprimtaritë formuese dhe kërkimore  Aneksi Nr. 91-PhD Open Day</p>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore siguron mekanizma promovimi dhe mbështetje për studentët që të marrin pjesë në aktivitete dhe	<p>UMT si institucion, dhe në veçanti njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT (FSHKIT), mbështet studentët e ciklit të tretë me marrëveshje me institucione partnere jashtë vendit, ku studentët zhvillojnë pjesë të aktivitetit të tyre kërkimor.</p>

veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit në fushën e veprimtarisë së tyre.	Gjithashtu, institucioni ka realizuar disa marrëveshje, ku mund të përmendet ajo me Ambasadën Franceze, e cila ka rezultuar në opfrimin e bursave të studimit për 5 studentë të këtij programi studimi (tre studentë nga brezi i parë dhe dy nga brezi i dytë). UMT ka gjithashtu një sërë marrëveshjesh aktive në kuadër të projekteve Erasmus+, ku marrin pjesë jo vetëm studentët e këtij programi studimi, por edhe studentë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Aneksi Nr. 14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës Aneksi Nr. 23-Mbështetja financiare për doktoratën Aneksi Nr. 76-Bursat e fituara në kuadër të doktoratës Aneksi Nr. 77-Metropolitan Innovation Center Grant Agreement						
<b>Kriteri 4.</b> Studentët doktorantë bëhen pjesë e aktiviteteve kërkimore, projekteve dhe veprimtarive të tjera të njësisë përgjegjëse.	Studimet e ciklit të tretë, doktoratë, në thelb kanë aktivitetet e kërkimit shkencor në kuadër të projekteve të kërkimit shkencor dhe zhvëllimor ku këto studime realizohen. Studentët gjithashtu e këtij programi studimi, janë të përfshirë edhe në aktivitete të kërkimit shkencor, projekte, të realizuara nga institucioni si në kuadër të thirrjeve kombëtare të financuara nga AKKSHI, ashtu edhe nga ato në kuadër Interreg apo të tjera të financuara nga komuniteti European. Aneksi Nr. 70-Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+ Aneksi Nr. 71-Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT Aneksi Nr. 72-Lista e projekteve të fituara						
<b>Kriteri 5.</b> Studentët doktorantë promovohen në zhvillimin e aftësive të komunikimit, didaktike duke u angazhuar në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë.	Studentët e ciklit të tretë, doktoratë në UMT, përtej objektivave të kërkimit shkencor në projektin individual, janë pjesë e angazhimit akademik pranë këtij institucioni në fushën e tyre të kompetencës. Pjesë e këtij angazhimi është edhe angazhimi në ciklet e para dhe të dyta të studimit të ofruara nga institucioni, në rolin e asistent lektorit. Aneksi Nr. 40-Model kontrate pune doktoranti						
<b>Konkluzione</b>	<i>UMT në zhvillimin e ciklit të tretë doktoratë, bazon aktivitetin e kërkimit shkencor në projekte individuale të kërkimit shkencor. Disa prej tyre janë në bashkëpunim me institucione partnere jashtë vendit. I gjithë aktiviteti i kërkimit shkencor miratohet me fillimin e studimeve dhe vlerësohet në fund të çdo viti.</i>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përnibushet pjesësisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përnibushet pjesësisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përnibushet pjesësisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Veprimtaria akademike dhe shkencore e doktorantëve është pjesë integrale e veprimtarive të institucionit dhe ndihmon në rritjen e performancës së kërkimit shkencor në nivel institucional.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentëve u krijohen mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore	UMT si institucion, dhe në veçanti njësi kryesore, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT (FSHKIT), mbështet studentët e ciklit

<p>të institucionit të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjekin studimet e doktoratës.</p>	<p>të tretë me marrëveshje me institucione partnere jashtë vendit, ku studentët zhvillojnë pjesë të aktivitetit të tyre kërkimor.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka realizuar disa marrëveshje, ku mund të përmendet ajo me Ambasadën Franceze, e cila ka rezultuar në ofrimin e bursave të studimit për 5 studentë të këtij programi studimi (tre studentë nga brezi i parë dhe dy nga brezi i dytë).</p> <p>UMT ka gjithashtu një sërë marrëveshjesh aktive në kuadër të projekteve Erasmus+, ku marrin pjesë jo vetëm studentët e këtij programi studimi, por edhe studentë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.</p> <p>Aneksi Nr. 14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës  Aneksi Nr. 70-Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+  Aneksi Nr. 71-Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT  Aneksi Nr. 72-Lista e projekteve të fituara  Aneksi Nr. 76-Bursat e fituara në kuadër të doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Studentëve u krijohen mundësitë të zbatojnë metodologjitë e reja të kërkimit që ata aplikojnë në dobi të institucionit.</p>	<p>Institucioni, ciklin e tretë të studimeve, doktoratë, e sheh jo vetëm si një mundësi të zhvillimit të karrierës të studentëve, por si një mundësi reale për pjesëmarrje dhe fitimin e projekteve ndërkombëtare. Kjo është pjesë e strategjisë së institucionit për tu rritur dhe për të qenë konkurrent në një treg gjithnjë e më global.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi angazhohen edhe në mësimdhënie në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, ku angazhimi është në fushën e tyre të kompetencës dhe vet doktorantët përçojnë dije dhe njohuri të kërkimit shkencor që ata zhvillojnë në kuadër të studimeve të tyre.</p> <p>Aneksi Nr. 72-Lista e projekteve të fituara</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Doktorantët mbështeten të përfshijnë në punën e tyre kërkimore personel akademik dhe studentë të institucionit ose institucioneve partnere.</p>	<p>Mënyra e organizimit të studimeve të doktoratës në UMT, ku një pjesë e procesit të kërkimit shkencor zhvillohet edhe me mbikqyrje nga personel akademik i universiteteve të huaja, rrit cilësinë e studimeve në këtë cikël studimi.</p> <p>Aneksi Nr. 14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës  Aneksi Nr. 71-Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT  Aneksi Nr. 72-Lista e projekteve të fituara</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni krijon mekanizmat e duhur mbështetës për promovimin e arritjeve të studentëve, patentimin e rezultateve, zhvillimin e mëtejshëm të ideve inovative që ata kanë.</p>	<p>UMT ka themeluar Metropolitan Research Institute (MRI), si një njësi e dedikuar e koordinimit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit të projekteve kërkimore dhe aplikimeve për fonde ndërkombëtare (Erasmus+, Horizon Europe). Kjo njësi është pjesë integrale e zhvillimit të studimeve të doktoratës. Kjo njësi përmbush kërkesat e Kodit të Cilësisë për “mjedise që nxisin hulumtimin, shpikjet dhe patentimin”.</p> <p>UMT ka ngritur edhe një Qendër për Inovacion dhe Sipërmarrje (Metropolitan Incubator) e cila mundëson edhe eksplorimin e rrjeteve të sipërmarrjes apo edhe patentimit të ideve inovatore të realizuara në UMT.</p> <p>Aneksi Nr. 05-Strategjia e zhvillimit UMT  Aneksi Nr. 77-Metropolitan Innovation Center Grant Agreement</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni përfshin studentët doktorantë në veprimtari të tjera jashtë programit të doktoratës, organet drejtuese dhe grupe pune.</p>	<p>Studentët e UMT në tërësi janë të përfshirë në organet kolegjiale në përputhje me statutin e institucionit, përfshirë këtu Senatin Akademik, Komisionet e etikës, cilësisë dhe zhvillimit akademik etj.</p> <p>Studentët janë gjithashtu edhe personel akademik në njësitë bazë të përkatësisë ku përfshihen edhe në proceset administrative të tyre.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi janë të angazhuar edhe në grupe pune në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+, Interreg etj.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi angazhohen edhe në aktivitete akademike për programe studimi të cikleve të mëparshme.</p> <p>Aneksi Nr. 09-Vendimi për ngritjen e GVB</p> <p>Aneksi Nr. 52-Përfshirja e studentëve në organet kolegjiale</p> <p>Aneksi Nr. 78-Vendim për këshilltarët akademik FSHKIT</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UMT përfshin në mënyrë aktive doktorantët në projekte kërkimore, publikime shkencore dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e performancës kërkimore në nivel institucional.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="560 752 751 831">Përbushet plotësisht</td> <td data-bbox="751 752 983 831">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="983 752 1198 831">Përbushet</td> <td data-bbox="1198 752 1414 831">Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet	Përbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni ka prioritet kryesor ndërkombëtarizimin e studimeve në programin e doktoratës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i doktoratës përfshin doktorantë të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare.</p>	<p>Aktualisht në këtë program studimi nuk ka studentë të regjistruar nga jashtë Shqipërisë, por kjo nuk është e përjashtuar në vitet në vijim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i doktoratës mundëson regjistrimin e doktorantëve që vijnë nga vende të tjera.</p>	<p>Kriteret e pranimit në këtë program studimi nuk janë diskriminuese për vendin apo origjinën e studentëve. Duke qenë ky program studimi i ciklit të tretë doktoratë, nuk parashikon kuota të veçanta për kandidatë brenda vendit dhe jashtë tij apo për kategori të caktuara. Kjo pasi pranimi është i hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret si dhe kalojnë fazën e konkursit.</p> <p>Aktualisht në këtë program studimi nuk ka studentë të regjistruar nga jashtë Shqipërisë, por kjo nuk është e përjashtuar në vitet në vijim.</p> <p>Aneksi Nr. 01-Statuti UMT</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit</p> <p>Aneksi Nr. 37-Lista e studentëve doktorant</p> <p>Aneksi Nr. 46-Paketa e përzgjedhjes dhe vendimmarrjes së kandidatëve brezi i parë</p> <p>Aneksi Nr. 47-Paketa e përzgjedhjes dhe vendimmarrjes së kandidatëve brezi i dytë</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimeve të doktoratës inkurajon mobilitetin e studentëve të huaj pranë institucionit ofrues.</p>	<p>Programi i studimit inkurajon dhe mbështet mobilitetin e studentëve të huaj përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta me universitete partnere.</p> <p>Përmes iniciativave si projekti Erasmus+ MARDS dhe marrëveshjeve me institucione kërkimore në Francë, SHBA dhe rajon, UMT ofron mundësi për bashkëpunime, bursa dhe mbështetje logjistike për studentët e huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet doktorale pranë institucionit.</p> <p>Aneksi Nr. -Rregullore e programit të studimit  Aneksi Nr. 14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës  Aneksi Nr. 70-Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+  Aneksi Nr. 71-Mobilitete stafi dhe studentësh FSHKIT</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimeve të doktoratës mundëson zhvillimin e së paku një eventit shkencor ndërkombëtar në 2 vjet të organizuar nga njësi përgjegjëse (simpozium, konferencë, kongres) i cili inkurajon pjesëmarrjen e kërkuesve të huaj.</p>	<p>UMT organizon rregullisht evente shkencore ndërkombëtare, të paktën një çdo dy vjet. Këtu mund të përmendet 5<sup>th</sup> International Conference on Computing, Networking, Telecommunications &amp; Engineering Sciences Applications 2024 (CoNTESA'24) e realizuar në Dhjetor 2024</p> <p><a href="http://www.contesa24.theiaer.org/index.html">http://www.contesa24.theiaer.org/index.html</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mbështet pjesëmarrjen e studentëve në eventendërkombëtare në të cilat prezantohen rezultatet e kërkimit të programit të doktoratës.</p>	<p>Universiteti Metropolitan Tirana mbështet aktivisht pjesëmarrjen e studentëve doktorantë në evente ndërkombëtare, ku ata prezantojnë rezultatet e kërkimeve të tyre.</p> <p>Përmes financimit, lehtësimeve administrative dhe mentorimit, institucioni synon të nxisë ekspozimin e doktorantëve në konferenca, simpoziume dhe ëorkshop-e, duke rritur kështu profilin ndërkombëtar të studimeve doktorale.</p> <p>Aneksi Nr. 23-Mbështetja financiare për doktoratën  Aneksi Nr. 73-VBA, projekt buxheti për kërkim-shkencor</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbështet publikimin e punimeve kërkimore të udhëheqësve shkencorë doktorantëve dhe personelit akademik, pjesë e programit të doktoratës.</p>	<p>UMT ofron mbështetje të vazhdueshme për publikimin e punimeve kërkimore të doktorantëve, udhëheqësve shkencorë dhe stafit akademik që janë pjesë e programit të doktoratës.</p> <p>Kjo mbështetje përfshin akses në revista të indeksuara, ndihmë në procesin e botimit dhe financim për publikime në platforma ndërkombëtare, duke nxitur cilësinë dhe ndikimin e kërkimit shkencor në nivel institucional.</p> <p>Aneksi Nr. 23-Mbështetja financiare për doktoratën  Aneksi Nr. 73-VBA89</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Përmes bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore jashtë vendit, si dhe pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, UMT synon të rrisë cilësinë akademike dhe ndikimin global të studimeve doktorale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.4****Studenti dëshmon realizimin e veprimtarive të kërkimit shkencor dhe përmbushjen e detyrimeve shkencore për marrjen e gradës “Doktor”.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi përfundimtar i studentëve të doktoratës bazohet mbi produktin kërkimor shkencor të tij i arritur gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve doktorale.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i studentëve të këtij programi studimi bazohet kryesisht në produktin kërkimor shkencor që ata kanë arritur gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p>Ky vlerësim përfshin publikimet, rezultatet eksperimentale, dhe kontributet inovative që demonstrojnë aftësitë dhe pjekurinë shkencore të doktorantit.</p> <p>Për përmbylljen me sukses të studimeve të ciklit të tretë, sikurse është e parashikuar në rregulloren e programit të studimit, në veçanti neni 13 të saj, studenti duhet të plotësojë kriteret e kërkuara në VKM 112, datë 23.02.2018 për “Përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” i ndryshuar.</p> <p>Përpara se të realizohet vlerësimi përfundimtar, studenti vlerësohet në përfundim të çdo viti në njësinë bazë përkatëse.</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 55-Vlerësimi i ecurisë vjetore nga Departamenti Aneksi Nr. 57-Komisionet mbi vlerësimin e ecurisë vjetore Aneksi Nr. 58-Vlerësimi i Oponentëve të jashtëm</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Studenti jep prova që me anë të kërkimit shkencor të realizuar, ai ka sjellë produkte shkencore origjinale, punime shkencore të një niveli të lartë shkencor, disa prej të cilave kanë merituar a meritojnë publikimin në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>	<p>Botimet shkencore të realizuara apo pjesëmarrjet në konferenca ndërkombëtare cilësore, janë tregues i origjinalitetit të kërkimit shkencor.</p> <p>Përpara se punimet e studentëve të këtij cikli studimesh të publikohen, realizohet edhe vlerësimi i origjinalitetit të tyre me platformën elektronike Turnitin.</p> <p>Aneksi Nr. 86-Publikimet shkencore Aneksi Nr. 31-Sistemi antiplagjiaturë Turnitin</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Udhëheqësi dhe student i doktorant garanton përmbushjen e detyrimeve lidhur me individualitetin e punimit dhe eliminimit të plagjiaturës në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të njësisë përgjegjëse.</p>	<p>Udhëheqësi dhe student i doktorant janë të përkushtuar që puna shkencore të jetë plotësisht origjinale dhe të respektojë plotësisht rregullat për shmangien e plagjiaturës. Ata ndjekin me kujdes kriteret dhe udhëzimet e përcaktuara në aktet rregullatore të njësisë përgjegjëse, duke garantuar kështu integritetin akademik të punimit.</p> <p>Gjatë gjithë procesit të zhvillimit të doktoraturës, udhëheqësi ka rol kyç në monitorimin dhe mbështetjen e studentit për të siguruar që puna të jetë unike dhe në përputhje me standardet më të larta shkencore. Nga ana tjetër, student i doktorant ka përgjegjësinë personale për të siguruar që çdo pjesë e punës së tij është rezultat i hulumtimeve të veta dhe i referencave të sakta.</p> <p>Ky bashkëpunim i ngushtë dhe përkushtimi ndaj rregullave është themeli për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve kërkimore, duke ruajtur kështu prestigjin e programit të doktoratës dhe të institucionit përgjegjës.</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit</p>

	<p>Aneksi Nr. 15-Rregullore e Etikës së Doktoratës  Aneksi Nr. 28-Udhëzues për kontrollin e plagjiaturës  Aneksi Nr. 31-Sistemi antiplagjiaturë Turnitin</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studenti jep prova të veprimtarisë kërkimore të nivelit të lartë siç janë publikime me citime, veprimtari botuese e kërkimore-shkencore jashtë vendit, prezantime të rezultateve në nivel ndërkombëtar, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, projekte, etj.</p>	<p>Studentët tregojnë angazhim serioz në kërkimin shkencor, rezultatet e të cilat paraqiten në konferenca ndërkombëtare të lidhura ngushtësisht me fushën e këtij programi studimi.  Megjithatë, nuk ka akoma një brez që të kenë përmbyllur këtë program studimi, dhe të ketë kaluar një periudhë kohore, e nevojshme që punimet shkencore të botuara të mund të referohen nga kërkimtar të tjerë të komunitetit shkencor në këtë fushë.  Aneksi Nr. 72-Lista e projekteve të fituara  Aneksi Nr. 86-Publikimet shkencore</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studenti dëshmon se ka plotësuar kriteret bazë, që duhen përpara mbrojtjes së disertacionit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;</li> <li>• Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 2 (dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës, me bord editorial, ku, së paku, në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin autor i dytë.</li> </ul>	<p>Për përmbylljen me sukses të studimeve të ciklit të tretë, sikurse është e parashikuar në rregulloren e programit të studimit, në veçanti neni 13 të saj, studentit duhet të plotësojë kriteret e kërkuara në VKM 112, datë 23.02.2018 për "Përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" i ndryshuar.  Këtu përfshihet realizimi i së paku tre referimëve si autor i parë ose i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi, dhe dy nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;  Gjithashtu, kërkohet që studentit të ketë botuar së paku tre artikuj në revista shkencore nga të cilët dy të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës, me bord editorial, ku, së paku, në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin autor i dytë.  Megjithatë, në kohën e vlerësimit të këtij programi dhe vizitës në institucion, nuk ka akoma një brez studentësh që të kenë përfunduar këtë program studimi për të vlerësuar përpftshmërinë e plotë të këtij kriteri.  Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit  16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Studenti dorëzon dhe prezanton punimin e plotë para jurisë së ngritur nga njësi përgjegjëse si parakusht i mbrojtjes finale para jurisë së miratuar nga Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” duke garantuar përmbylljen e cilësisë akademike të disertacionit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programi të studimit si dhe në rregulloren e komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore doktor, institucioni vlerëson në mënyrë periodike të përvitshme ecurinë e studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Në përfundim edhe të realizimit të pjesëmarrjes në konferenca dhe botimet e kërkuara, studenti harton edhe disertacionin sipas një formati të miratuar.</p> <p>Vetë pasi studenti ka kaluar të gjitha hallkat monitoruese/vlerësuese në njësinë bazë dhe atë kryesore, përgatitet për të paraqitur punimin e tij përpara jurisë si akt përmbyllës.</p> <p>Megjithatë, duke mos patur një brez studentësh që ta kenë përfunduar këtë program studimi, është e mundur vlersimi i përmbylljes së këtij kriteri vetëm nga ana dokumentare, pa një ballafaqim gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit  Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor  Aneksi Nr. 25-Template për hartimin e disertacionit  Aneksi Nr. 26-Template për prezantimet  Aneksi Nr. 31-Sistemi antiplagjiaturë Turnitin</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në rast të mospërmbylljes së detyrimeve, studenti bën plotësimet e vërejtjeve, rekomandimeve dhe i prezanton ato para jurisë së njësisë përgjegjëse brenda një periudhe 3 mujore.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit parashikohet edhe të drejtat dhe detyrimet e studentit si dhe të drejtat dhe detyrimet e udhëheqësit shkencor. Në këto akte parashikohen edhe rolet e secilit prej tyre për sa i përket realizimit të detyrimeve ligjore të doktoratës, sikurse janë botimet dhe pjesëmarrja në aktivitete referuese, por edhe prezantimet në njësinë bazë të përkatësisë.</p> <p>Megjithatë në rregullore nuk ka të parashikuar rastin kur juria mund të mos aprovojë fitimin e gradës shkencore “Doktor”, kur vëren mospërmbyllje të detyrimeve, si dhe paraqitjen e tyre për plotësim.</p> <p><i>Rekomandohet që në rregulloren e programit të studimit apo në atë të Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor, të përfshihen edhe rastet kur Juria për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor, nuk e miraton.</i></p> <p><i>Të parashikohet në rregullore rastet kur kandidati për arsye madhore nuk paraqitet në mbrojtjen e gradës shkencore doktor.</i></p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UMT ka hartur rregullore dhe udhëzues të cilat orientojnë studentin në realizimin e veprimtarive të kërkimit shkencor dhe përmbylljen e detyrimeve shkencore për marrjen e gradës “Doktor”.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**

**Studenti përgatit disertacionin për marrjen e gradës “Doktor” dhe dokumentacionin e nevojshëm dhe e paraqet atë para jurisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” miraton jurinë e mbrojtjes së disertacionit në përbërje të së cilës janë anëtarë nga kategoria “profesor” të fushës që mbulon studimi i doktoratës dhe së paku një prej tyre të jetë me gradën PhD ose më shumë nga një institucion i vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u vlerësua roli, të drejtat dhe detyrimet e Komisionit të Përhershëm për Dhënien e gradës shkencore Doktor.</p> <p>Në Rregulloren e programit të Doktoratës, neni 10, pika 2 (10.2), thuhet: “Anëtarët e jurisë propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga njësia kryesore. Numri i tyre është jo më pak se 8, nga të cilët Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore 'Doktor' zgjedh 5 anëtarë.”</p> <p>Ndërkohë, në Rregulloren e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, neni II/2, pika 6, përcaktohet se: “Ky komision është përgjegjës për miratimin e përbërjes së jurisë për mbrojtjen e doktoratës, mbi propozimin e njësisë bazë.”</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si dhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore.</p>	<p>Në aktet rregullatore të brendshme janë të miratuara formatet standarde për hartimin e disertacionit si dhe formatin e prezantimeve. Megjithatë, nuk ka akoma një brez studentësh të këtij programi studimit që të kenë arritur në fazën përmbyllëse të këtij programi për të verifikuar efektivisht zbatimin e këtyre formateve.</p> <p>Por gjykojmë se për sa kohë ato janë të miratuara, do të zbatohen nga studentët për shkrimin e disertacionit.</p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor Aneksi Nr. 25-Template për hartimin e disertacionit Aneksi Nr. 26-Template për prezantimet</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor përpara dorëzimit dhe vlerësohet njësia përgjegjëse sipas përcaktimeve në aktet rregullatore dhe së bashku me dokumentacionin mbështetës kalon për shqyrtim në Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.</p>	<p>Udhëheqësi shkencor i studentit të ciklit të tretë, ka të drejta dhe detyrime të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Ndër to, është mentorimi i studentit për kohëzgjatjen e studimit dhe në fund edhe miratimin e disertacionit. Kjo e fundit certifikohet me siglimin e disertacionit nga udhëheqësi.</p> <p>Edhe pse në RVB, institucioni ka përkrahur procedurën që ndiqet nga kërkesa e kandidatit për të mbrojtur gradën shkencore Doktor, vlerësimi në departament, vlerësimin në Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor, dhe Juria përkatëse, ky informacion nuk është i reflektuar saktë në rregulloren e programit të studimit apo në atë të Komisionit të përhershëm përkatës, ku përmendim së paku nga RVB:</p> <p><i>Procedura për miratimin e disertacionit. pas vlerësimit nga komision ad-hoc i ngritur nga departamenti. kalon për shqyrtim në Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". Kjo procedurë është e strukturuar mirë në Rregulloren e programit të doktoratës. Procedura është si me poshte:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kandidati e dorëzon disertacionin e perfunduar. se bashku me dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për</i></li> </ul>




	<p><i>vlerësim Departamentit. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Pas vlerësimit nga Departamenti te disertacionit dhe dosjes së kandidatit. brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Dekani ia percjell Drejtorit të shkollës së doktoratës dhe koordinatorit te programit per vleresim të kriterëve formale dhe kontrollit antiplagjiature:</i></li> <li>• <i>Pas vlerësimit të tyre, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". brenda 5 (pesë) diteve.</i></li> <li>• <i>Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurine per vlerësimin e disertacionit.</i></li> </ul> <p>Ku procedura e më sipërme është e duhur, por në rregulloren e programit të studimit, ajo është paraqitur nën nenin 10 "Organizimi i Jurisë", edhe pse procedura sa më sipër, nuk janë pjesë e veprimtarisë së jurisë.</p> <p>Rekomandojmë institucionit, që procedura e ndjekur dhe e përshkruar edhe në RVB si më sipër, të reflektohet në nenet e duhura si të rregullores së programit të studimit apo në atë të komisionit të përhershëm.</p> <p>RVB Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 25-Template për hartimin e disertacionit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Komisioni i përhershëm garanton cilësinë e punës kërkimore shkencore, përmbushjen e objektivave të përcaktuar nga kandidati dhe detyrimeve akademike ligjore për marrjen e gradës doktor.</p>	<p>Institucioni, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, ka ngritur Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor", dhe për të cilin ka hartuar edhe rregulloren përkatëse.</p> <p>Institucioni e ka të qartë rolin dhe funksionimin e këtij komisioni, sikurse e paraqet atë edhe në RVB por edhe në rregulloren e komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor"</p> <p>RVB Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" garanton përmbushjen e detyrimeve lidhur me individualitetin e punimit dhe eliminimit të plagjiaturës në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të njësisë përgjegjëse.</p>	<p>UMT ka të përcaktuar disa prej roleve dhe përgjegjësi të Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor, ku ndër to është edhe vlerësimi i aktivitetit kërkimor shkencor të studentëve të këtij programi studimi, përfshirë edhe vlerësimin e origjinalitetit të punimit me platformën elektronike Turnitin.</p> <p>Aneksi Nr. 15-Rregullore e Etikës së Doktoratës Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor Aneksi Nr. 28-Udhëzues për kontrollin e plagjiaturës</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Nëse Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" vlerëson pozitivisht disertacionin,</p>	<p>Procedura është pjesërisht e përshkruar në rregulloren e programit të studimit dhe pjesërisht në rregulloren e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor, në veçanti Kreu II, pika 2, 3 dhe 4 e saj.</p>

<p>përmbledhjen e miratuar nga udhëheqësi shkencor së bashku me raportimet, vlerësimet e njësisë përgjegjëse. vijon me prezantimin para jurisë.</p>	<p>Megjithatë, sikurse është përmendur edhe për kriteret më sipër, institucioni ka qartësuar më mirë dhe më në detaje funksionimin e këtij komisioni në RVB sesa në rregulloren e tij. Prandaj sugjerojmë që këto përshkrime të bëhen pjesë e rregullores, sikurse është praktika që institucioni realisht ndjek. Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Procedura më të detajuara për fitimin e gradës shkencore “Doktor” përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë, rregulloren e ciklit të tretë të studimeve dhe rregulloren e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.</p>	<p>Në statutin e UMT, në nenin 23 parashikohen Komisionet e përhershme, ku ndër to është edhe ai për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Komision që detajohet në nenin 25 të statutit . Në rregulloren e programit të studimit, në veçanti neni 9, parashikohen përgjegjësitë e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Dhe rregullorja e këtij komisioni përmbush aktet rregullatore të nevojshme që rregullojnë veprimtarinë e këtij komisioni. Megjithatë, vërehet se në të gjithë këto akte, përshkrimi i funksionimit, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet, qofshin edhe to kohore të vendimmarrjes, nuk janë të qartësuar. Institucioni ka përshkruar më në detaje në RVB funksionimin e këtij komisioni sesa në rregulloret përkatëse. Aneksi Nr. 01-Statuti UMT Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UMT ka hartuar rregulloret e nevojshme për mbikëqyrjen e studimeve të doktoratës nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre, megjithatë këto rregullore kanë nevojë të plotësohen me procedura apo nene që qartësojnë funksionimin e tyre, në përputhje me atë që institucioni realisht realizon, sikurse e ka përshkruar edhe në RVB.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## V. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN DOKTORAL

<p><b>Standardi V.1</b> Institucioni dhe njësia përgjegjëse lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të doktoratës, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: Rruga Skënderbeg, Blloku i Ambasadave, Tiranë 1001  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



52

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka të sanksionuar në Statut përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>Njsbc është ngritur me Vendim të Senatit Akademik, dhe ka në përbërjen e saj 5 anëtarë të përhershëm dhe 1 ekspert të jashtëm. Njsbc ka hartuar politikën e Cilësisë në institucion, funksionon mbi bazën e rregullores së Njsbc, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe (një) ekspert i jashtëm dhe (një) përfaqësues i administratës. Anëtarët e Njësive miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.</p> <p>Aneksi Nr. 48-VSA mbi miratimin e Njsbc Aneksi Nr. 49-Rregullore e Njsbc Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor Njsbc</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Angazhimin institucional për krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, UMT e ka parashikuar në planin e zhvillimit strategjik të institucionit, në të cilin parashikohet përgjegjësia institucionale për konsolidimin e cilësisë dhe mekanizmat me të cilat kjo do të arrihet. Gjithashtu, institucioni në plotësim të objektivave strategjike të tij lidhur me sigurimin e cilësisë, ka në nivel drejtuesi zv/rektorin për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Aneksi Nr. 48-VSA mbi miratimin e Njsbc Aneksi Nr. 49-Rregullore e Njsbc Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor Njsbc</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Njsbc harton në mënyrë periodike anketime të procesit mësimor dhe atij shkencor si për studentët ashtu edhe për stafin akademik. Të dhëna që paraqiten në formë raporti për organet eprore.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ndjek procedurat e kërkuara nga ASCAL për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit.</p> <p>Aneksi Nr. 48-VSA mbi miratimin e Njsbc Aneksi Nr. 49-Rregullore e Njsbc Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor Njsbc</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pyeti në lidhje me interpretimin e rezultateve dhe mekanizmave formal, sasior në interpretimin e tyre për të nxjerrë të dhëna të dobishme në rritje të cilësisë së institucionit.</p> <p>Vlerësojmë pozitive hartimin e raporteve nga Njsbc dhe mënyrën e interpretimit të të dhënave në nivel institucioni dhe jo vetëm për program studimi. Njsbc bën një interpretim të pyetjeve për të ndërthurur me njëra-tjetrën për të nxjerrë informacione në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Aneksi Nr. 48-VSA mbi miratimin e Njsbc</p>

	Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC			
<b>Konkluzione</b>	<i>UMT ka të ngritur strukturat e nevojshme për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni dhe njësia përgjegjëse monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programin të doktoratës, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të doktoratës.	<p>UMT ngritur njësitë e tij për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ku përgjegjësia kryesore është e njësisë bazë që ofron programin e studimit, e ndjekur nga njësia kryesore e më pas nga institucioni në tërësi me mekanizmat e tij. Njësia bazë koordinon të gjithë aktivitetet didaktike të programit, si dhe koordinon punën për realizimin sa më cilësor të tij.</p> <p>Në UMT përgjegjësia administrative për sigurimin e cilësisë bie mbi drejtuesin e departamentit dhe koordinatorin e programit të studimit edhe pse detyrat e këtij të fundit janë në formë koordinimi, por pa specifikuar rregulloret e arritjes së tyre.</p> <p>Gjithashtu, institucioni, në bashkëpunim me institucionet partnere me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi edhe në kuadër të studimeve të ciklit të tretë, mbështet mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të doktoratës.</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT Aneksi Nr. 15-Rregullore e Etikës së Doktoratës Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor Aneksi Nr. 17-Vendimi i Senatit për Rregulloren e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës Doktor Aneksi Nr. 18-Vendimi i Senatit për rregulloren e Etikës së Doktoratës Aneksi Nr. 24-Model formulari i raportit të progresit për studentët e Doktoratës Aneksi Nr. 52-Përfshirja e studentëve në organet kolegjiale Aneksi Nr. 61-Anketime të studentëve doktorant</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me njësinë e sigurimit të cilësisë, u vu re se kjo zyrë harton raporte bazuar kryesisht mbi anketimet e studentëve. Ekzistojnë edhe procedura për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime të tyre.

	<p>UMT ka mekanizma të tillë si analiza vjetore në rang fakultetesh, ku evidentohet cilësia e personelit akademik, cilësia e syllabuseve, cilësia e literaturës së përdorur, rezultatet e studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit etj, duke hartuar një plan masash për përmirësim e programit të studimit.</p> <p>Në këtë kontekst është edhe përfshirja e studentëve të këtij programi studimit, si në rolin si student, ashtu edhe në rolin si personel akademik i këtij institucioni.</p> <p>Përfshirja e tyre garantohej edhe në organet kolegjiale ashtu edhe në komisionet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për hartimin e raporteve të brendshme.</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT  Aneksi Nr. 15-Rregullore e Etikës së Doktoratës  Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor  Aneksi Nr. 17-Vendimi i Senatit për Rregulloren e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës Doktor  Aneksi Nr. 18-Vendimi i Senatit për rregulloren e Etikës së Doktoratës  Aneksi Nr. 24-Model formulari i raportit të progresit për studentët e Doktoratës  Aneksi Nr. 52-Përfshirja e studentëve në organet kolegjiale  Aneksi Nr. 61-Anketime të studentëve doktorant</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ka përcaktuar indikatorë dhe tregues cilësorë të matshëm sasiorë për programin e doktoratës në kudër të vlerësimit të cilësisë së programit.</p>	<p>UMT ka hartuar politika të sigurimit të cilësisë në tërësi si institucion, dhe në veçanti edhe për programin e studimit të ciklit të tretë doktoratë. Treguesit cilësorë janë të përcaktuar që në pranimin e studentëve të doktoratës, në rregulloren përkatëse, ku pranimi i studentëve kërkon si kusht zotërimin e një mesatare të ponderuar të cikleve paraardhëse të studimit <math>\geq 8</math>, përveç rasteve specifike që mund të gjykohen nga komisioni përkatës i pranimit.</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT  Aneksi Nr. 24-Model formulari i raportit të progresit për studentët e Doktoratës  Aneksi Nr. 52-Përfshirja e studentëve në organet kolegjiale  Aneksi Nr. 61-Anketime të studentëve doktorant</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit.</p>	<p>Në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit është edhe monitorimi i kritereve cilësore dhe sasiorë të diktuar nga VKM 112, datë 23.02.2018 për “Përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”” i ndryshuar.</p> <p>Përpara se të realizohet vlerësimi përfundimtar, studenti vlerësohet në përfundim të çdo viti në njësinë bazë përkatëse si për avancimin e tij në kërkimin shkencor në fushën e tij të studimit, ashtu edhe në publikimin e rezultateve të këtij kërkimi.</p> <p>Përtej vlerësimit të përvitshëm në njësinë bazë, studentët e këtij programi studimi janë edhe pjesë e anketimeve periodike të realizuara</p>

	<p>nga njësia përkatëse e sigurimit të cilësisë, e cila vlerëson me anë të pyetësorëve në tërësi të gjithë aspektet e jetës akademike, kërkimore shkencore dhe bashkëpunimet e studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p> <p>Aneksi Nr. 24-Model formulari i raportit të progresit për studentët e Doktoratës</p> <p>Aneksi Nr. 52-Përfshirja e studentëve në organet kolegjiale</p> <p>Aneksi Nr. 61-Anketime të studentëve doktorant</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore të programit të studimit të doktoratës. Mbledhja e të dhënave për përgatitjen e raporteve vjetore dhe raporteve të vlerësimit të brendshëm bëhet përmes koordinimit të Zyrës së Rektorit dhe Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sipas politikave institucionale.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë realizohet në mënyrë periodike, në raportet e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike që është edhe njësia përgjegjëse për këtë program studimi</p> <p>Njësia bazë, është e para që analizon ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik.</p> <p>Të gjitha gjetjet në procedurat dhe metodologjitë për sigurimin e cilësisë u përcillen autoriteteve vendimmarrëse për programin e studimit (përgjegjës departamenti/dekan) si dhe organeve kolegjiale (dekanati/senati akademik) të cilët, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore marrin masat përkatëse.</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p> <p>Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë analizën e anketimeve dhe vënien në dukje të gjetjeve të tyre. Por nuk ka të dhëna mbi vlerësimet, vendimet, planet e masave dhe objektivat e vendosura nga institucioni për të adresuar gjetjet e raporteve të hartuara nga NJSBC apo organet e tjera në kuadër të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Gjykojmë se institucioni vepron në përmirësimin e cilësisë me procedura të padokumentuara qartësisht, të cilat kanë sjellë rritje të cilësisë së institucionit sikurse mund të kuptohet edhe nga historia e akreditimeve të programve të studimit dhe atij institucional. Megjithatë GVJ mendon se institucioni ka vend për përmirësime të mëtejshme në procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe trajnimin e stafit që angazhohet në këto detyra.</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p> <p>Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC</p> <p>Aneksi Nr. 89-Raportimet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore</p>

	Aneksi Nr. 90-Planet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore			
<b>Konkluzione</b>	<i>Organizimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UMT garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni dhe njësia përgjegjëse përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit doktoral kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore të programit të studimit të doktoratës. Mbledhja e të dhënave për përgatitjen e raporteve vjetore dhe raporteve të vlerësimit të brendshëm bëhet përmes koordinimit të Zyrës së Rektorit dhe Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sipas politikave institucionale.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë realizohet në mënyrë periodike, në raportet e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike që është edhe njësia përgjegjëse për këtë program studimi</p> <p>Njësia bazë, është e para që analizon ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik.</p> <p>Të gjitha gjetjet në procedurat dhe metodologjitë për sigurimin e cilësisë u përcillen autoriteteve vendimmarrëse për programin e studimit (përgjegjës departamenti/dekan) si dhe organeve kolegjiale (dekanati/senati akademik) të cilët, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore marrin masat përkatëse.</p> <p>Aneksi Nr. 07-VBA për akreditimin institucional Aneksi Nr. 89-Raportimet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore Aneksi Nr. 90-Planet vjetore të veprimtarive formuese dhe kërkimore Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC RVB PhD AI&amp;IS (Shqip)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën që ka programi i doktoratës.	<p>Pjesë e sigurimit të brendshëm të cilësisë për këtë program studimi, edhe për natyrën e tij të bazuar në kërkimin shkencor, është edhe bashkëpunimi me institucionet partnere të arsimit të lartë jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu, pjesë e vlerësimit janë edhe opionetët e jashtëm për disertacionet e studentëve, Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor, komisionet vlerësuese në njësinë bazë, etj.</p>

	<p>Në këtë kuadër, institucioni ka të ngritur edhe sistemin e vlerësimit të origjinalitetit të punimeve të doktoratës me platformën digjitale Turinitin.</p> <p>Aneksi Nr. 14-Marrëveshjet në kuadër të Doktoratës  Aneksi Nr. 28-Udhëzues për kontrollin e plagjiaturës  Aneksi Nr. 29-Komisioni i përheshëm për dhënien e gradës Doktor  Aneksi Nr. 55-Vlerësimi i ecurisë vjetore nga Departamenti  Aneksi Nr. 56-Raporti vjetor UMT  Aneksi Nr. 57-Komisionet mbi vlerësimin e ecurisë vjetore  Aneksi Nr. 58-Vlerësimi i Oponentëve të jashtëm</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit doktoral përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë.</p>	<p>UMT, për vlerësimin e cilësisë për cdo student në këtë program studimi, përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të mirëpërcaktuara për kontrollin periodik dhe udhëzimin e studentëve për rritjen cilësore të kontributit të tyre shkencor, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Formulari i raportit të progresit për studentët e doktoratës i cili plotësohet nga doktoranti dhe udhëheqësi</li> <li>• Vlerësimi i oponentit të jashtëm. pjesë e komisionit ad-hoc për ecurinë vjetore të doktorantit, formati i vlerësimit mund të merret edhe i universiteteve partnere</li> <li>• Vlerësimi vjetor përfundimtar i kryer nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</li> <li>• Vlerësimi i dizertacionit dhe dosjes së doktorantit nga Komisioni i Përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor</li> </ul> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit  Aneksi Nr. 53-Vlerësime, komente, komunikime udhëheqës-doktorant  Aneksi Nr. 55-Vlerësimi i ecurisë vjetore nga Departamenti  Aneksi Nr. 57-Komisionet mbi vlerësimin e ecurisë vjetore</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit doktoral përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, të personelit akademik, kërkues shkencor, udhëheqësve dhe partnerëve.</p>	<p>Pjesë e aktivitetit të njësisë së brendshme për sigurimin e cilësisë, institucioni realizon anketime periodike, jo vetëm me studentët e këtij programi studimi, por në tërësi me të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucioni. Përtej seksioneve të anketimit të lidhura ngushtësisht me objektivat e programit të studimit, pjesë e pyetësorëve janë edhe argumenta rreth kushteve të punës, bazës laboratorike , ndërveprimi student/mentor, etj.</p> <p>Gjithashtu, duke qenë studentët e këtij programi studimi të angazhuar edhe në aktivitete didaktike, ata marrin pjesë edhe në anketime apo vlerësime, opinione, sugjerime për përmirësimin e vazhduar si të aktiviteteve akademike ashtu edhe ato të kërkimit shkencor.</p> <p>Pjesë e këtij vlerësimi dhe përçimi të dijeve, janë edhe ditët e hapura, ku studentët e këtij programi studimi paraqesin arritjet e tyre, mundësitë e reja për zhvillim përçimin e dijeve në brezat e rinj.</p> <p>Aneksi Nr. 61-Anketime të studentëve doktorant  Aneksi Nr. 91-PhD Open Day</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Mekanizmat e vlerësimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit, përfshijnë palët e interesuara, institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në nivel institucionale kryen misionin e saj në bashkëpunim me të gjitha organet kolocgjiale, dhe në veçanti me njësitë bazë përgjegjës për programet e studimit. Kjo njësi kontribuon në mbikëqyrjen dhe zhvillimin e rregulloreve, politikave, programeve, proceseve akademike dhe jo akademike dhe siguron përputhjen me kuadrin ligjor. Operimi i këtyre strukturave mbështetet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë në të cilin janë detajuar procedurat që duhen ndjekur dhe standardet që duhen plotësuar gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë. Në këtë proces përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. GVJ u informua për përfshirjen në këtë proces të studentëve, stafit akademik, por edhe të një eksperti të jashtëm.</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT Aneksi Nr. 51-Plan pune i Zyrës së Cilësisë dhe Kurrikulës</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>NJSBC, është njësi përgjegjëse në nivel institucional për monitorimin dhe rritjen e cilësisë së programeve të studimit të ofruara në UMT. NJSBC ka të miratuar rregulloret dhe planet vjetore të punës për monitorimin periodik të cilësisë së brendshme për këtë program studimi duke ndjekur të gjitha hapat e që në pramimin e studentëve deri në diplomimin e tyre</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b> <b>Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC të programit të doktoratës dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit doktoral.</p>	<p>Në dokumentet rregullatore të këtij institucioni thuhet se “<i>të gjitha strukturat përbërëse të UMT janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që ai ofron bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore</i>”. Synimi kryesor i përcaktuar në këto akte është gjithëpërfshirja e kontribuesve në procesin e mësimdhënjes dhe aktiviteteve të tjera akademike. Në këtë kuadër, përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit në vlerësim është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Pikërisht kjo njësi përgjegjëse ka ngritur, propozuar, aktivizuar e monitoruar gjithë aktivitetin për SC. Po ashtu fakulteti ka koordinuar këtë aktivitet, realizimi i të cilit pastaj kërkon gjithëpërfshirje të strukturave të institucionit. RVJ konstaton që SC për pragramin në vlerësim është realizuar me përfshirjen e gjithë aktorëve, të brendshëm e të jashtëm, të interesuar dhe të ngarkuar për këtë process. Aneksi Nr. 48-VSA mbi miratimin e NJSBC Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC</p>

	<p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p> <p>Aneksi Nr. 52-Përfshirja e studentëve në organet kolegjiale</p> <p>Aneksi Nr. 59-Leksione të hapura, në kuadër të doktoratës</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UMT, mbështetur në aktet ligjore (Ligji 80/2015) dhe ato rregullatore ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NjsBC, në përbërje të së cilës ka aktorë të brendshëm, studentë dhe aktorë të jashtëm. Të dhënat e kërkuara dhe të siguruar nga kjo zyrë i vihen në dispozicion GVB i cili harton RVB. GVJ i ka konsultuar të gjitha materialet e DVV, ka hartuar protokollin e takimeve në institucion dhe konstaton që aktorët e ngarkuar për SC i kanë ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre.</p> <p>Aneksi Nr. 01-Statuti UMT</p> <p>Aneksi Nr. 02-Rregullore e brendshme UMT</p> <p>Aneksi Nr. 06-Rregullore e FSHKIT</p> <p>Aneksi Nr. 15-Rregullore e Etikës së Doktoratës</p> <p>Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p> <p>Aneksi Nr. 36-Rezultatet e vlerësimit të procesit të kërkimit shkencor</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e gjithë materialeve të DVV si dhe në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ vlerëson se njësia bazë dhe ajo kryesore janë përfshirë në sigurimin e dokumentacionit të kërkuar për hartimin e DVV.</p> <p>Aneksi Nr. 01-Statuti UMT</p> <p>Aneksi Nr. 02-Rregullore e brendshme UMT</p> <p>Aneksi Nr. 06-Rregullore e FSHKIT</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC</p> <p>Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në vizitën në institucion, dhe në veçanti takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, vlerësohet respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtarëve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion.</p> <p>Aneksi Nr. 01-Statuti UMT</p> <p>Aneksi Nr. 02-Rregullore e brendshme UMT</p> <p>Aneksi Nr. 06-Rregullore e FSHKIT</p> <p>Aneksi Nr. 15-Rregullore e Etikës së Doktoratës</p> <p>Aneksi Nr. 16-Rregullore e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor</p> <p>Aneksi Nr. 36-Rezultatet e vlerësimit të procesit të kërkimit shkencor</p>

	<p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC Aneksi Nr. 50-Politikat e cilësisë në UMT</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>NJSBC por edhe grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga anëtarë të brendshëm të institucionit.</p> <p>Gjatë takimit në institucion, në veçanti takimi me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të silabuseve të lëndëve.</p> <p>Ka edhe tentativa bashkëpunimi me universitete jashtë Shqipërisë për diploma të dyfishta apo njohje reciproke të programeve të studimit. Në kuadër të studimeve të ciklit të tretë, doktoratë, ka edhe bashkëpunime me institucione jashtë vendit me të cilat realizohen aktivitete të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p> <p>Aneksi Nr. 29-Komisioni i përheshëm për dhënien e gradës Doktor Aneksi Nr. 57-Komisionet mbi vlerësimin e ecurisë vjetore Aneksi Nr. 58-Vlerësimi i Oponentëve të jashtëm Aneksi Nr. 59-Leksione të hapura, në kuadër të doktoratës</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Monitorimi i ecurisë akademike e programit të doktoratës dhe sigurimi i cilësisë, është pjesë e veprimtarisë së njësisë përgjegjëse e Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe NJSBC.</p>	<p>Institucioni, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, ka ngritur Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, dhe për të cilin ka hartuar edhe rregulloren përkatëse.</p> <p>Megjithatë, edhe pse institucioni e ka të qartë rolin dhe funksionimin e këtij komisioni, sikurse e paraqet atë edhe në RVB, këto nuk janë të reflektuara në mënyrë të qartë në rregulloren e vet komisionit.</p> <p>Rregullorja e komisionit, përbëhet nga 5 (pesë) krerë, për një total prej 3 faqe materiale (5 faqe në total, por faqe e parë është kopertinë, e dyta përmbajtja dhe 3 faqet e fundit përshkruajnë rregulloren).</p> <p>Institucioni ka përshkruar më në detaje në RVB funksionimin e komisionit sesa në rregulloren e tij.</p> <p><i>Rekomandojmë që institucioni të pasurojë rregulloren e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, sipas roleve, të drejtave, përgjegjësisë dhe detyrimeve që i kanë përshkruar korrektësisht në RVB.</i></p> <p>Aneksi Nr. 10-Rregullore e programit të studimit Aneksi Nr. 29-Komisioni i përheshëm për dhënien e gradës Doktor Aneksi Nr. 57-Komisionet mbi vlerësimin e ecurisë vjetore Aneksi Nr. 58-Vlerësimi i Oponentëve të jashtëm Aneksi Nr. 59-Leksione të hapura, në kuadër të doktoratës</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Procesi i sigurimit të cilësisë përfshin të gjitha hallkat administrative dhe akademike të UMT. Njësia bazë është e para e prëfshirë dhe me peshën më të madhe në vlerësimin e gjetjeve të vlerësimit të brendshëm dhe përmirësimin e tyre. Në këtë kuadër, përfshihen studentët por edhe bashkëpunëtorët e jashtëm të institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në faqen zyrtare në web publikohen raporte të përmbledhura për programet e studimit të cilat evidentojnë kryesisht pikat e forta të institucionit [<a href="https://umt.edu.al/njofitime-dhe-publikime">https://umt.edu.al/njofitime-dhe-publikime</a>].</p> <p>Të dhëna më të detajuara u ofrohen studentëve gjatë nënshkrimit të kontratës kur regjistrohen si studentë në një program studimi. Në këtë fazë studenti njihet me dokumentin e performancës së institucionit dhe në veçanti për programin e studimit të përzgjedhur.</p> <p>Aneksi Nr. 36-Rezultatet e vlerësimit të procesit të kërkimit shkencor Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC Aneksi Nr. 56-Raporti vjetor UMT Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni dhe njësia përgjegjëse publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të pyetësorëve të organizuar jepen në formë të përmbledhur. Të dhënat jepen në formë anonime dhe statistikore në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Të përmbledhur jepen edhe të dhëna tërësore si për programe studimi ashtu edhe për institucionin të publikuara në faqen ueb zyrtare</p> <p>Të dhënat e aksesueshme nga stafi në kuadër të raporteve apo anketimeve në lidhje me cilësinë e brendshme apo raporte specifike mbi vlerësimin e stafit janë konfidenciale në qasjen e plotë ndërsa të përpunuara bëhen publike brenda institucionit.</p> <p>Stafi akademik në nënshkrimin e kontratës së punës pranë UMT, pranon të ruajë të dhënat sensitive me të cilat haset gjatë aktiviteti në UMT.</p> <p>Gjithashtu institucioni rikujton/trajnon në mënyrë të vazhduar personeli rreth konfidencialitetit.</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC Aneksi Nr. 51-Plan pune i Zyrës së Cilësisë dhe Kurrikulës Aneksi Nr. 60-Rregullore e sistemit CCTV Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC <a href="https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=HCiëJkUo404">https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=HCiëJkUo404</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>NJSBC dhe GVB paraqesin raportet mbi gjetjet dhe vlerësimet si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Në përmbyllje të raporteve ka një analizë mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t’u fokusuar në evidentimin e pikave të forta. Për pikat e dobëta dhe sugjerimeve dhe masat që mund të ndërmerren, mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore por edhe institucioni për ti përmirësuar ato në të ardhmen.</p> <p>Aneksi Nr. 51-Plan pune i Zyrës së Cilësisë dhe Kurrikulës Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të doktoratës.</p>	<p>Sipas RVB, proccset e vlerësimit në kuadër të akreditimit të UMT si institucion apo si programe, kanë patur impakt në ndërgjegjësimin e të gjitha strukturave, personelit akademik dhe studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton që UMT çmon dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit në vlerësim.</p> <p>Aneksi Nr. 49-Rregullore e NJSBC Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe njësia përgjegjëse organizon veprimtari periodike me personelin akademik përgjegjëse dhe studentët doktorantë për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të doktoratës.</p>	<p>Për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit të ciklit të tretë, NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakulteteve. Takime kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale. Po ashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Grupin e Vetëvlersimit dhe NJSBC, çka u mundëson atyre që të përcjellin në mënyrë të vazhdueshme mendimet e tyre mbi problemet e cilësisë dhe të sugjerojnë masa që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të saj.</p> <p>Aneksi Nr. 59-Leksione të hapura, në kuadër të doktoratës Aneksi Nr. 95-Raporti vjetor NJSBC</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të elementëve që kanë të bëjnë me këtë proces.</i></p> <p><i>Gjithashtu, anketimet e realizuar me studentët, pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative të UMT, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV kontribuojnë në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
----------------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--------------------------------------------------------------------------

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Inteligjencia Artificiale dhe Sistemet Inteligjente” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Metropolitan Tirana”**

**Pikat e forta dhe afirmime**


1. Stafi akademik udhëheqës në këtë program doktoral rezulton i kualifikuar dhe kompetent në fushat e projekteve kërkimore-shkencore, duke i orientuar doktorantët drejt së dobishmes dhe duke i motivuar për përvetësim cilësor e të qëndrueshëm të njohurive. **(Standard III.2)**
2. Universiteti Metropolitan Tirana ka një numër relativisht të lartë të marrëveshjeve institucionale si për aktivitetet didaktike ashtu edhe për projekte kërkimore-shkencore. **(Standard III.1)**
3. Pjesëmarrje në disa projekte ndërkombëtare dhe shkëmbime stafi për avancimin akademik. **(Standard IV.2)**
4. Financim në mase të plotë për studentët aktual doktoral dhe lehtësira për studentët e ardhshëm në këtë program studimi. **(Standard II.4; Standard III.6)**

**Pika të dobta**

1. Mungesa e një laboratorit të çertifikuar kufizon mundësitë për zhvillimin e kërkimit shkencor eksperimental dhe për aplikimin praktik të njohurive në fushat AI. **(Standard III.4)**
2. Burimet infrastrukturore dhe teknike janë ende të pamjaftueshme për të mbështetur plotësisht një program doktore në fushën e inteligjencës artificiale dhe sistemeve inteligjente, sidomos për kërkime të avancuara. **(Standard III.4)**

**Rekomandime**

1. Rekomandohet që në rregulloren e programit të studimit apo në atë të Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore Doktor, të përfshihen edhe rastet kur Juria për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor, del me vendim negativ për fitimin e gradës shkencore. **(Standard IV.4)**
2. Të parashikohet në rregullore rastet kur kandidati për arsye madhore nuk paraqitet në mbrojtjen e gradës shkencore doktor, dhe mundësitë që i jepen në vijim. **(Standard IV.4)**
3. Sugjerojmë institucionin të rishikojë rregulloren e programit të studimit për të shpërndarë në mënyrë më të organizuar në nene, detyrat, të drejtat, përgjegjësitë dhe proceset e këtij cikli studimi dhe aktorëve të përfshirë në të. **(Standard IV.1)**



**Evaluation's conclusions for the third cycle study program Doctorate in "Artificial Intelligence and Intelligent Systems" provided by the Higher Education Institution Metropolitan Tirana University**

**Strengths and affirmations**


1. The leading academic staff involved in this doctoral program is qualified and competent in the fields of scientific research projects, guiding doctoral students toward results outcomes and motivating them to acquire knowledge in a high-quality and sustainable manner. **(Standard III. 2)**
2. Metropolitan University of Tirana has a relatively high number of institutional agreements, both for teaching activities and scientific research Projects **(Standard III.1)**.
3. Engagement in various international projects and staff exchange programs to promote academic development **(Standard IV.2)**.
4. Full financial support is granted to current doctoral students, with additional benefits and incentives available for prospective candidates in this academic program **(Standard II.4; Standard III.6)**.

**Weaknesses**

1. The absence of a certified laboratory limits opportunities for the development of experimental scientific research and the practical application of knowledge in the field of Artificial Intelligence. **(Standard III.4)**
2. The existing infrastructure and technical resources remain insufficient to fully support a doctoral program in Artificial Intelligence and Intelligent Systems, especially with regard to the requirements of advanced research activities. **(Standard III.4)**

**Recommendation**

1. It is recommended that the study program regulation or the regulation of the Permanent Commission for the Award of the Doctoral Degree include provisions addressing cases in which the Defense Jury issues a negative decision regarding the awarding of the doctoral degree. **(Standard IV.4)**
2. The regulation should foresee cases in which the candidate, due to force majeure, is unable to attend the doctoral degree defense, as well as outline the subsequent options available to the candidate. **(Standard IV.4)**
3. We recommend that the institution revise the study program regulations to more clearly structure, in distinct articles, the duties, rights, responsibilities, and procedural aspects of this study cycle, as well as those of all stakeholders involved **(Standard IV.1)**.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT DOKTORAL</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT DOKTORAL</b>				<b>X</b>
<b>III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT</b>				<b>X</b>
<b>IV. KËRKIMI SHKENCOR, ARRITJET DHE REZULTATET</b>				<b>X</b>
<b>V. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN DOKTORAL</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>